

Dr. Kiril Temkov

**ETIKA**  
PËR KLASËN VI

**Autor:**

Prof. Dr. Kiril Temkov

**Recensentë:**

Doc. Dr. Svetlana Kamxhijash  
Mr. Gordana Nikçevska  
Dushanka Golluboviq-Neshoska

**Lektor i botimit në maqedonisht:**

Violeta Karaxhovska-Stojanova

**Përkthyes:**

Xhevdet Shabani

**Redaktim profesional:**

Prof.Dr. Asllan Hamiti

**Lektor i botimit në shqip:**

Mr. Ismail Hamiti

**Redaktor:**

Aleksandar Temkov

**Përpunimi kompjuterik:**

Bojana Dimitrova

**Kopertina:**

Dime Temkov, grafik akademik

**Korrekturë:**

Aleksandar Temkov

**Botues:**

Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë

**Shtyp:**

Qendra Grafike shpkpv, Shkup

**Tirazhi:**

8.300

Me vendim të ministrit të Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë nr. 22-4100/1 datë 06.07.2010 lejohet përdorimi i këtij libri.

CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека "Св.Климент Охридски", Скопје  
373.3.016:54(075.2)=163.3  
ТЕМКОВ, Кирил  
Етика за VI одделение / Кирил Темков. - Скопје : Министерство за образование и наука на Република Македонија, 2010.  
- 67 стр. : илустр. ; 26 см  
ISBN 978-608-226-010-5  
COBISS.MK-ID 84089866

Të dashur miq të rinj,

Ky është **LIBËR NGA ETIKA**, i cili i mëson njerëzit ç'është e Mira, e ç'është e Keqja. Gjëja më mirë për njeriun është të bëjë mirë, e t'i largohet së keqes. Prandaj fëmijët mësohen që në fëmijëri se si duhet të sillen drejt. Nëse njeriu bën mirë, edhe atij i bëhet mirë, sikurse edhe njerëzve që i ka përreth. Nëse njeriu e ndjell të keqën dhe bën diçka keq atëherë edhe ai do të ndjehet keq, siç do ta kenë vështirë edhe njerëzit me të cilët kontakton ai.

Në lëndën e Etikës mësohet si dhe pse njerëzit duhet të veprojnë drejtë dhe cila është ajo që nuk duhet bërë asnjëherë. Në libër jepen këshilla direkte dhe norma morale, të cilat duhet t'i ndjekim. Gjithashtu, shpjegohet morali dhe rregullat e sjelljes së mirë në rrethana të ndryshme dhe në situata të ndryshme, me ushtrime dhe përsëritje të shpeshta, si dhe me shembuj, të cilat na japin mësim edukativ për sjelljen e mirë të njeriut.

Libri ndahet në tri pjesë - (1) për etikën dhe moralin, (2) për vlerat e përgjithshme etike të njerëzve dhe (3) për thelbin dhe llojet e sjelljes së mirë. Ne kemi dëshirë që të rinjtë të mësojnë mire etikën, që të bëhen njerëz të mirë dhe t'u bëjnë mirë të gjithëve, të kujdesen për vetveten dhe për shëndetin e tyre, të ruajnë natyrën dhe të dinë t'i kryejnë detyrimet morale dhe t'i zgjidhin çështjet morale me të cilat do të përballen në jetë dhe në punë.

Në pjesën e parë të librit **ETIKA DHE MORALI** bëhet fjalë për shkencën mbi moralin dhe për veprimet të cilat te njerëzit vlerësohen si të mira dhe të këqija dhe në bazë të së cilave i vlerësojmë njerëzit me të cilët takohemi në përditshmërinë tonë.

Gjithashtu, këtu do të mësojmë se si duhet të bëhet zgjedhja etike midis të mirës dhe të keqes, si dhe çfarë dobie do të na sjellë përcaktimi i drejtë moral.

Në këtë aspekt, do të shpalosen sidomos mësimet e dijetarit më të madh maqedonas në fushën e etikës, Shën Klimentit të Ohrit, si bazë e etikës sonë. Krahas themelimit të shkollave dhe dhënies së njohurive njerëzve në të gjitha fushat, ky paraardhës yni më i ditur i ka mësuar gjyshërit tanë si të sillen sipas normave morale, e kjo edhe sot e kësaj dite për ne është shumë e rëndësishme.

## Ç'ËSHTË ETIKA

Anëmbanë botës sot shumë flitet për etikën. Ashtu është edhe në vendin tonë. I qortojnë ata që janë të këqij dhe nuk veprojnë sipas moralit, u thonë se nuk kanë etikë. Kurse ata të cilët janë të sinqertë, punëtorë dhe u ndihmojnë njerëzve, vlerësohen të mirë, që e ndjekin etikën. Për ata të cilët mendojnë dhe veprojnë me dhunë, llogariten se kanë humbur etikën. Për të rinjtë në të gjitha vendet aplikohet arsimimi etik (siç kemi mësimin për Etikën) dhe kërkohet që të mësohen bazat themelore të etikës dhe vlerat që përmbajnë norma, që të mund ta mbrojnë dhe praktikojnë etikën.

Etika është një ndër veprat më të rëndësishme, më të nevojshme dhe më të dobishme të njerëzimit. Ajo flet për qëllimet dhe veprat e mira të njeriut.

Pse këto janë aq të rëndësishme? Ato gjithmonë kanë qenë të rëndësishme, sepse është më mirë të bëjmë mirë dhe të jetojmë në paqe dhe qetësi, me punë të dobishme dhe në harmoni, pa pasur frikë dhe pa fyerje ndaj të tjerëve – se të ndiqet e keqja, të veprohet keq, dikujt t'i shkaktohet dhembje ose dikush të lëndojë dikë. Sot kjo është edhe më e rëndësishme, për arsye se kemi shumë njerëz në botë dhe konfliktet e tyre sjellin pasoja të fuqishme negative, kemi edhe armatim të rëndë, armatim dhe preparate kimike të cilat mund të na sjellin dëme të mëdha. Edhe Natyra është e lënduar. Prandaj kërkohet prej njerëzve të veprojnë mirë dhe jo keq, të vetëdijësohen, të mendojnë me dëshirë që të bëhet mirë për secilin dhe të veprohet mirë. Bashkimi i botës bashkëkohore, i cili çdo ditë është gjithnjë e më i fuqishëm, mund të japë rezultate të mira vetëm nëse njerëzit kanë kujdes çka bëjnë dhe nëse ua dëshirojnë vetëm të mirën njerëzve të tjerë dhe natyrës.

Etika flet për atë se çka është e mirë dhe çka është e keqe,

### **MIRË**

**është ajo që është pozitive, që pëlqehet, që është e dobishme, zgjidhet dhe rekomandohet, duhet të bëhet**

Mirë është të kihet dashuri, nëse punohet nëse ka mirëkuptim, kur ndihmojmë, kur japim, respektojmë njerëzit dhe jetojmë në paqe me të tjerët.

### **KEQ**

**është ajo që është negative, që nuk pëlqehet, që është e padobishme, që refuzohet, që shmanget, nuk duhet të bëhet**

Keq është kur urrehet, kur kemi përtaci nëse nuk ka mirëkuptim, kur nuk ndihmojmë, kur nuk e ndajmë me të tjerët, kur nuk respektojmë njerëzit dhe jetojmë në konflikt.

ajo na tregon cila është e mira dhe cila e keqja në jetë, dhe në të gjitha fushat e jetës: në punë, në familje, në marrëdhëniet midis njerëzve, në qëllimet dhe hapat e ndryshëm të njeriut në jetë. Në të gjitha këto kemi gjëra të mira dhe gjëra të këqija. E mira duhet, kurse e keqja nuk duhet dhe duhet ta shmangim.

**ETIKA – E NDJEK TË MIRËN!  
E FLAK TË KEQEN**

**Etika ia tregon njeriut rrugën e drejtë** na jetë, drejtim të cilit duhet gjithmonë ta ndjekim dhe të kemi kujdes të mos largohemi prej saj. Etika insiston që ne të bëhemi bamirës të vëmë re dhe të kujdesemi, të kemi dashuri dhe të ndihmojmë. Etika e tregon atë që është më e rëndësishme, e cila për njeriun duhet të jetë e drejtë. E kjo është të konsiderohet qenie morale, ta bëjë më të mirën, të jetë i kënaqur/e kënaqur nga sjellja e vet, qenie të cilën të gjithë e respektojnë, e duan dhe e respektojnë për shkak të veprimit moral.


Etika është **SHKENCË PËR MORALIN**, për konceptin e njeriut mbi të Mirën dhe të Keqen dhe veprimet e tij me të cilat e ndjek të Mirën dhe i largohet të Keqes. Në këtë mënyrë jetojmë drejt dhe shkohet përpara në jetë, krijohet personaliteti i vërtetë, i afërt me të tjerët para së gjithash shok i vetvetes. Ky është qëllimi i njerëzve të drejtë.

Etika ndihmon njerëzit ta gjejnë rrugën e drejtë të jetës dhe nëse paraqitet nevoja, të përmirësohen. Rregullat e saj quhen **norma morale**. Me etikë të mirë jeta dhe marrëdhëniet midis njerëzve bëhen të mira dhe kemi progres. Etika është diçka pozitive – kurse e kundërta paramendimi dhe të bërit keq, mos heqja dorë prej së keqes - gjithmonë është diçka negative. Prandaj etika është një nga shkencat dhe veprimtaritë e para dhe më të rëndësishme. Gjithsecili doemos duhet të mësojë t'i dallojë kundërthëniet që ekzistojnë midis të mirës dhe të keqes dhe të bëjë zgjidhjen e vërtetë - të ndjekë të mirën dhe të largohet prej së keqes. Arsimimi Etik është pjesë përbërëse e formimit të personalitetit të pjekur, të lirë dhe të përgjegjshëm. Me diturinë etike njeriu do të zgjedhë rrugën e vërtetë në jetë, do të bëjë mirë, do ta ruajë mjedisin jetësor dhe drejtë do të sjillet me njerëzit.

**MASË -**

dimension i saktë, përcaktim i mirë, i mençur; vështrim dhe vlerësim i drejtë i nevojave, qëllimeve, veprimeve dhe pasojave - një nga vlerat më të rëndësishme të moralit; për Aristotelin matura është procedurë ideale etike (*e kundërta*: pamatura, mungesa e masës)

**NOCIONET  
KRYESORE  
ETIKE**



Fjalën **Etikë** e ka shpikur filozofi i njohur Aristoteli (384-322 para erës sonë), i cili ka qenë mësues i Aleksandrit të Madh. Aristoteli i ka quajtur etike ato qëllime dhe veprime të cilat janë vlerësuar me kujdes, mirë të menduara, drejt, të cilat janë më të “mirat”. Atëherë njerëzit veprojnë me maturi të vërtetë. Etika flet për përcaktime dhe vepra të tilla të shkëlqyeshme - të cilat janë shumë të nevojshme, meqë paqesin bazë për moral të mirë.

**E MIRA ËSHTË QËLLIMI I TËRË ASAJ QË EKZISTON DHE I ÇDO VEPRIMTARIE**  
*Aristoteli*

Si e komentoni këtë mendim të filozofit Aristotel?



**ËSHTË E DUHUR**

- + Të duhet etika!
- + Të bëjmë mirë!
- + Ta ndihmojmë tjetrin!
- + Të jemi të qetë dhe tolerantë!



**NUK ËSHTË E DUHUR**

- Të anashkalohej etika!
- Të bëjmë keq!
- Të nënçmohet tjetri!
- Të jemi të dhunshëm!

Mendoni për këto **rekomandime etike**. Ç’duhet bërë? Çka nuk duhet bërë? Bisedoni përse ato janë propozuar si **norma etike**.



**FJALORI**  
**ETIK**

**etikë** - shkencë për moralin, për zgjedhjen dhe të bërit mirë, si dhe shmangien e së keqes

**rrugë e drejtë** - mënyra si duhet të ecim, gjithmonë drejt, pa u shmangur dhe pa bërë gjëra të këqija.

**pozitive** – ajo që vlen, nga e cila del diçka e mirë, ajo që është e nevojshme

**negative** – ajo që nuk vlen, nga e cila del diçka e keqe, që është e dëmshme dhe e panevojshme

**normë etike** - ajo që duhet bërë (domosdo) ose që nuk duhet bërë: shënohet me *pikëçuditje* (!) - Ndihmoji të tjerët! Mos gënje!

# MORALI

Në jetë kemi situata të ndryshme dhe vlerësim të moralit:

Petriri i rrah fëmijët - të gjithë e konsiderojnë atë të dhunshëm dhe asnjëri nuk dëshiron të shoqërohet me të, përveç atyre të cilët edhe vetë janë të dhunshëm. Njomza është e butë dhe gjithmonë buzëqesh - dhe të gjithë e thërrasin në shoqëri.

Behari nuk pastrohet rregullisht - të gjithë largohen prej tij për shkak të papastërtisë dhe erës që kundërmon.

Arti u ndihmon gjithmonë të tjerëve - dhe të gjithë e lavdërojnë.

Amari e ndan ushqimin e tij me të gjithë të uriturit dhe të gjithë i japin atij diçka nga ajo që kanë sjellë.



Shikoni se çfarë sjellje të ndryshme kemi dhe çfarë karakteristika hasim te njerëzit. E tërë kjo bazohet në dy grupe themelore - ose i kemi të mirë ose të këqij. Veprat e mira quhen **morale** dhe personat të cilët veprojnë cilësohen si të **moralshëm**. Veprat e këqija cilësohen si të pamoralshme dhe njerëzit i vlerësojnë si të pamoralshëm personat të cilët kanë sjellje të këtilla.

**Morali është një ndër karakteristikat më të rëndësishme të njeriut.** Te kafshët po ashtu mund të shohim elemente të moralit (kujdesi i tyre për të vegjlit, bashkëpunimi dhe ndihma e anëtarëve të llojit të njëjtë, dashuria dhe lidhja mes çifteve, qëndrueshmëria dhe këmbëngulja gjatë aritjes së qëllimeve). Mirëpo kafshët veprojnë sipas instinkteve, sjellja e tyre është shprehje e nevojave të tyre biologjike, pa vetëdije, dhe nuk është rezultat i asaj që kanë zgjedhur vetë ata. Vetëm qenia njerëzore mund të dallojë të keqen dhe të mirën dhe të sillt në mënyrë të mirë, të dobishme, të pëlqyer dhe të largohet nga e keqja.

Ky është thelbi i moralit - njohja e së mirës, të duhet e mira dhe punët e mira, po ashtu edhe njohjen e së keqes dhe largimi prej saj.

**E mira dhe e keqja janë gjëra të kundërta** njëra me tjetrën, ato konsiderohen si dy pole të cilat nuk mund të bashkohen dhe të përzihen. Ajo që është e mirë nuk është e keqe, dhe ajo që është e keqe nuk mund të jetë e mirë. Secili nga ne e dallon të mirën dhe të keqën prandaj ashtu sillt dhe i vlerëson të tjerët.

MIRË

KEQ

Dallimet mes njerëzve nuk varen gjithmonë prej personalitetit të njeriut. Gjinia, mosha, raca, nacionaliteti, gjuha dhe talenti janë të formuara në mënyrë natyrore. Çdo njeri këto karakteristika i fiton që nga lindja e tij. Njerëzit janë të njëjtë dhe këto dallime nuk janë shumë të rëndësishme për të vlerësuar njeriun. Njerëzit vlerësohen sipas karakteristikave të mira ose të këqija, veprimet e tyre janë të mira apo të këqija, janë të moralshëm ose të pamoralshëm. Këto karakteristika dallohen prej individit, etikës që ka ai (ajo) për orientimin dhe rrugën që ka zgjedhur në jetë. Njeriu mund të vlerësojë veten ashtu siç e vlerësojnë të tjerët atë.

**Rregullat e Moralit** - norma, për e njeriut, është ndjenjë, vetëdije dhe dituri e çdo aktivitet njerëzor, njeriut për të mirën

Morali është veti e veçantë dhe veprimtari. Morali ka **rregulla** si duhet të cilat tregojnë si të veprohet bërë mirë dhe si të largohemi nga e keqja. Njeriu me moral e shikon drejt jetën, në ndërkohë është edhe burim i energjisë me të cilën njeriu vepron mirë.

Kur njeriu është i moralshëm ndihet i rehatshëm, krenar, i lartësuar, lavdërohet dhe të tjerët e lavdërojnë atë.

Atëherë ndërgjegjja e tij është e pastër dhe nuk brengoset. Ai/ajo e di se janë në rrugë të vërtetë dhe veprat e tyre nuk do të lëndojnë askënd, por do t'u sjellin dobi të tjerëve, kështu që ai/ajo i bëjnë mirë vetvetes. Atëherë lumturinë që e ndjen njeriu në vete është e vërtetë, ai/ajo janë të vetëdijshëm se janë pjesëtarë të dobishëm të njerëzimit. Morali pozitiv është bazë për një jetë më të mirë, fisnike dhe të lumtur për njerëzit.

Çfarë sjellje keni me shokët tuaj?

- me respekt
- urdhëroj
- urrej
- nuk komunikoj
- kam mirëkuptim
- ndihmoj
- me dashuri
- këshilloj, mësoj
- mosinteresim
- tolerancë
- mundohem t'i shfrytëzoj
- i falë ata....



Vlerësoni zgjedhjen që keni bërë a është e mirë. Nëse është mirë - a duhet të vazhdoni, të prisni dhe të kërkoni prej të tjerëve të vepronë në mënyrë të njëjtë? Nëse sjellja nuk është e mirë - a duhet ta ndryshoni?



## NOCIONET KRYESORE ETIKE

### **MORALE/AMORALE-**

bërja e veprave të mira, e cila përputhet me moralin që është moralisht e vlefshme # bërja e veprave të këqija që është në kundërshtim me moralin, që nuk është moralisht e vlefshme

### **MORAL PERSONAL -**

Parime morale, norma dhe veprime të një njeriu (sistemi moral) që janë karakteristikë e tij.

### **MORALI SHOQËROR (SOCIAL)-**

Parimet morale, dobitë dhe normat e një shoqërie që janë bazë e veprimeve morale dhe vlerësimit.

**Nënë Tereza** (1910-1997), personaliteti më i njohur moral i epokës së re moderne, iu përkushtua të varfërve dhe të sëmurëve në qytetin Kalkuta dhe anembanë botës, bashkë me të u bashkëngjitën me mijëra vullnetarë të rinj, ndërtoi spitale, shkolla për fëmijët e varfër. Fitoi çmimin më të lartë për paqe Nobel në vitin (1979). Ajo, edhe pse me trup të vogël dhe të imtë tregojë se çfarë fuqie ka mirësia e njeriut kur vendosim të veprojmë mirë duke ndihmuar njerëzit e varfër. Nënë Tereza është fytyrë e moralit bashkëkohorë.



## **NUK MUND TË BËJMË PUNË TË MËDHA, MIRËPO PUNËT E VOGLA MUND T'I BËJMË ME DASHURI TË MADHE**

*Nënë Tereza*

Komentoni thënien  
e Nënë Terezës

## **TRE BURIME TË MORALIT**

**Morali lind në shoqëri**, nga pëlqimi i përgjithshëm i shumicës së pjesëtarëve të saj duke u nisur prej asaj që diçka që është e mirë dhe që duhet bërë (duhet që tërë ajo shoqëri të bëjë atë), kurse diçka që është e keqe dhe që nuk duhet bërë (asnjeri në atë shoqëri nuk duhet bërë atë). Për shkak se kemi shoqëri të ndryshme (prej familjes e deri te njerëzimi në përgjithësi), kemi morale të ndryshme varësisht prej kuptimeve dhe qëllimeve të shoqërisë.

**Morali zhvillohet në njësinë**, sipas vlerësimit dhe idesë, që ajo i zgjedh, dhe vendos bazën e moralit i cili do të ndiqet në jetë.

- por edhe ky moral vlerësohet në shoqëri, për shkak se prek anëtarët e saj, nëse nuk është i mirë mund të lëndojë dikë.

**Morali pranohet prej njohurive që kemi nga e kaluara nga mbarë bota**, prej historisë së popullit të saj dhe popujve të tjerë, prej njerëzve të mençur të cilët kanë folur për gjërat më të rëndësishme për të Mirën dhe për të Keqen (të tilla janë mësimet e Krishtit, Muhamedit a.s , të filozofit të mirënjohur Sokrat, sot të Nënë Terezës).

## ETIKA DHE MORALI



### POZITIVE ËSHTË

- + të ruhet morali
- + të kryhen detyrat
- + të jemi të drejtë



### NEGATIVE ËSHTË

- të ikim prej moralit
- të ikim prej detyrave
- të jemi të padrejtë

Mendoni për këto **rekomandime etike**. Çka duhet bërë? Çka nuk duhet bërë? Bisedoni pse janë dhënë këto rekomandime si **norma morale**.



### FJALORI ËTIK


**vlerë** - ajo që vlen, që duhet ndjekur

**parim** - princip, bazë, ajo që paraqitet në gjithçka

**detyrë** - ajo çka duhet bërë, çka nuk duhet shmangur

**shembull** - shembulli më i mirë që duhet ndjekur në jetë

**mësim** - gjërat që janë treguar janë udhërrëfyes si duhet vepruar



Shkruani rregullat:

- në komunikacion
- në shkollë
- në basketboll
- në familje

## RËNDËSIA E MORALIT

Secili nga ne ka lindur dhe jeton, me ç'rast më e rëndësishme është ekzistimi i njeriut të jetë i vërtetë dhe njerëzor, në jetë të kemi veti të mira dhe të bëjmë vepra të mira. Kjo nënkupton të jemi të moralshëm.

Gjatë periudhave të ndryshme kemi kategori të ndryshme dhe raste të ndryshme, kemi mësim të rëndësishme etike dhe kërkesa - të cilat janë në përputhje me dispozitat morale. Këtu shohim njerëzimin dhe forcën e ekzistimit. Kur kemi të bëjmë me ndonjë katastrofë dhe varfëri të madhe njerëzit ndihmojnë njëri-tjetrin. Sot të gjithë ne jemi të brengosur për mbijetesën e natyrës dhe është e domosdoshme që të sillemi në mënyrë ekologjike, të gjithë ne duhet të kujdesemi për natyrën dhe gjallesat në të.

Kur kemi vështirësi, e rëndësishme është që të durohet dhe të përmirësohet gjendja. Në situata të mira është e panevojshme që të krenohemi. Në varfëri duhet që të shtrëngohemi dhe të fitojmë. Kur të kemi duhet të kursejmë dhe mos të harxhojmë. Gjatë robërisë shumë e rëndësishme ka qenë të jeni hero, në liri më human.

Dhe të mos lëndohen të tjerët. Gjithmonë duhet të ndjejmë gjërat pozitive, që paraqesin moral të mirë.

Morali do të thotë njerëzit të kenë qëllime të mira dhe të realizojnë vlera të vërteta, duke punuar për shoqërinë. Me rëndësi të madhe është që të jemi pozitivë, dhe të shmangim negativitetin. Kur kemi situata të vështira, qëndrimi pozitiv është kusht për jetë dhe përparim.



**Gjorgji - Goce Delçev** (1872-1903) është personaliteti më i njohur i lëvizjes moderne të Maqedonisë. Besonte se të gjithë njerëzit duhet të jenë të lirë, kurse liria mund të fitohet si rezultat i angazhimit të përbashkët serioz të pjesëtarëve të popujve të cilët jetojnë në një bashkësi, të cilët duhet të respektohen mes tyre dhe të bashkëpunojnë. Etika themelore dhe porosia e Goce Delçevit është që duhet të dallohemi me vepra morale.

**UNË BOTËN E  
RORE NDËRMJET**



**KUPTOJ SI NJË FUSHË PËR GARË KULTU-  
POPUJVE .**

*Goce Delçev*

Për të jetuar jetë të mirë me rëndësi është **qëndrimi pozitiv**, që do të thotë jetën ta shohim me gëzim, me shikim drejt gjërave pozitive (bamiësitë), kushtuar mirësive dhe bukurive të jetës. Që do të thotë të kemi buzëqeshje, ndaj gjërave të sillemi me respekt dhe interesim, njerëzit tjerë të pranohen në mënyrë të barabartë dhe të afërt. Duhet të veprojmë që të bëhet mirë për ne dhe për të tjerët. Qëndrimi pozitiv është një **bardhësi**.

E kundërta, **marrëdhëniet negative**, kuptimi i së cilës nënkupton të refuzohen vlerat e jetës, të paraqiten në sipërfaqe ana negative, të shmanget mundësia për lumturi, dhe të mos besohet në mundësinë e të jetuarit mirë. Fytyra është e vrenjtur. Për pengesat dhe vështirësitë normale fajësohet "fati i zi". Ngjyra e qëndrimit negativ është **e zeza**.

Thënia për qëndrimin pozitiv është: *Gjithçka është e mirë por mund të bëhet edhe më e mirë*. Edhe nesër ka ditë, e cila na pret me dritën e saj që ofron dritë, pas pikëllimit, përsëri do të këndojmë, pas rezultateve të dobëta dhe dështimit, nëse mundohemi do të vijmë edhe rezultatet tona, sukse-si dhe fitorja. Thënia e qëndrimit negativ është: *Asgjë nuk është mirë*. Pas gëzimeve gjatë verës vjen të ftohtit dhe varfëria e vjeshtës dhe dimri. Secila këngë është hyrje me situata pikëlluese. Pas çdo fitoreje vjen humbja.

**Qëndrimi pozitiv është gjithmonë më i rëndësishëm dhe më i arsyeshëm se qëndrimi negativ.**

**KUJDES, KUJDESJE -**

Interesimi dhe veprimi për të vepruar mirë për diçka dhe për dikë, përkushtim i realizimit të mirë të detyrës (e kundërta e moskujdesit dhe pakujdesisë).

**NOCIONET  
KRYESORE  
ETIKE**


**TË GJITHË NJERËZIT NUK MUND TË JENË  
TË PASUR DHE TË RËNDËSISHËM,  
POR SECILI MUND TË VEPROJË MIRË**

*Konfuqije*

Komentoni me shokët tuaj thënien e etikut më të njohur kinez.

**Mendimi dhe zgjedhja** janë forcat themelore të vlerave të njeriut. Ai zbulon dhe ndjek të mirën, të dobishmen, kurse largohet nga ajo që nuk sjell dobi. Zgjedhja tregon se çfarë individi është njeriu në të vërtetë: është i mirë, i kuptueshëm, serioz, i përgjegjshëm, i kujdesshëm - ose është i keq: i pakuptueshëm, joserioz, i papërgjegjshëm dhe person i pakujdesshëm, pa vetëdije dhe pa ndërgjegje të vërtetë.

Gjatë zgjedhjes njeriu mendon dhe i llogarit të gjitha veprimet e tij, vendos çfarë të bëjë dhe si të veprojë, vështron pasojat dhe zgjedh më të mirën për vetveten dhe të tjerët përreth tij. Morali është vendim i rëndësishëm për sjellje të mirë, të gjithë kanë interes dhe krijohen marrëdhënie të drejta mes njerëzve. Sjellja e keqe dhe e pamenduar mund të sjellë dobi, kështu mendon egoisti.

Kjo dobi është gjithmonë e përkohshme, për shkak se sjelljet e këqija i hakmerren secilit - për këtë merret ndëshkim dhe njerëzit flasin keq për atë që vepron keq dhe largohen prej tij. Pastaj si pasojë të keqe kemi edhe kur njerëz të pavetëdijshëm pëlqejnë vepra të këqija dhe fillojnë të veprojnë pa mend, nga ajo lind një situatë e padëshiruar mes njerëzve dhe pastaj bëjnë keq, luftojnë sikur bishat mes tyre, që sjell deri në dëmtimin e tyre.

Në përrallën popullore dy cjep the-  
ren mes tyre deri në vdekje në urën  
mbi përrua, ata nuk mund të zgjed-  
hin mënyrë më të mirë përveç se me  
kokat e tyre boshe të sulmojnë njëri-  
tjetrin.

## RREGULLA E ARTË ETIKE

Norma më e përhapur etike në botë (këshilla morale dhe mësim) thotë:

**BËJE ATË QË DËSHIRON TË TJERËT TË BËJNË PËR TY:  
MOS E BËJ ATË QË TË TJERËT NUK DËSHIRON TA BËJNË TY:**

Në rregullat etike të arta theksohet e përbashkëta në etikë. Me shembull duhet të tregohet çka njeriu zgjedh dhe për çka angazhohet, po ashtu të njëjtën e kërkon dhe pret prej njerëzve të tjerë. Elementare është perspektiva e sjelljes njerëzore. - Reciprociteti nuk është i mirë pasi që kemi bërë vepër të keqe, në kuptim të asaj që të kthehet e njëjta e keqe që është bërë: BËJE ATË QË (TY) TA BËJNË / TA KANË BËRË! Ajo është hakmarrje, që nuk është e mirë për normën etike.

Sipas të mirës dhe të keqes ndahen qëllimet dhe veprimet e moralit. E mira është pozitive, respektohet dhe rekomandohet, mbrohet dhe realizohet.

Personi krenohet me zgjedhjen e së mirës dhe veprimeve të mira, E keqja është negative, e padëshirueshme, hidhet poshtë, shmanget, nuk rekomandohet dhe tentohet largimi prej saj. E keqja nuk duhet mbrojtur, nga mbrojtja e së keqes dhe veprimeve të saj buron faji dhe vlerësimi i keq i individit.

Edhe çështjet tjera të etikës dhe të jetës së njeriut janë të ngjashme me domethënie të kundërt: morale dhe amoralë, etike dhe joetike, të drejta dhe jo të drejta, të vlefshme, të pavlefshme, ajo çka vlerësohet, që nuk vlerësohet, çka duhet bërë dhe çka nuk duhet bërë, ajo që doemos duhet të bëhet dhe ajo që doemos nuk duhet të bëhet dhe të largohemi prej saj... Me zgjedhjen midis të mirës dhe të keqes njeriu zgjedh mënyrën e jetës dhe të sjelljes, dhe vendos si do të jetë jeta e tij për atë dhe shoqërinë e tij, për të afërmit, për familjen, në përgjithësi për tërë njerëzimin.



### MIRË ËSHTË

- + Të mësojmë!
- + Të ndihmojmë të tjerët !
- + Të bëjmë sport!



### KEQ ËSHTË

- të mos mësojmë!
- të ikim prej përgjegjësive dhe të mos ndihmojmë në shtëpi!
- të mos bëjmë sport!

Mendoni për këto **rekomandime etike**. Çka duhet bërë! Çka nuk duhet bërë! Bisedoni pse janë dhënë këto rekomandime si **norma morale**.

## E MIRA E PËRGJITHSHME -

është ajo e cila vlerësohet nga të gjithë është e dobishme, të gjithë e pëlqejnë dhe e rekomandojnë

## QËLLIMKEQ -

vepër më qëllim të keq, me mendim të keq (*kund.* qëllimmirë)

**NOCIONET  
KRYESORE  
ETIKE**



Ju lutemi, pas mësimëve të para nga Etika, mendoni për pyetjet e ardhshme dhe përgjigjuni:

- A dëshironi të tjerët të sillen mirë me ty? A silleni ju mirë me të tjerët - me familjen tënde, shokët e shkollës dhe shokët e rrugës?
- A i dëgjoni ata të cilët ju këshillojnë për moralin dhe a pasqyrohet kjo në veprat tuaja?
- A mendoni që mësimi i etikës të bëhet normë e sjelljeve tua?



## FJALORI ETIK

**e njerëzishme, njerëzore** - që i takon njeriut, çka është e mirë të mendojnë dhe të bëjnë njerëzit

**vullneti i mirë** - qëllimi i mirë, veti e njerëzve të moralshëm

**fliten fjalë të mira** - vlerësim i moralit të individit (ka besim, dhe për të fliten fjalë të mira)

**vullnet të mirë** - bën diçka me gëzim, nuk ka përtaci

**shpirt i mirë** - me shpirt të mirë, pa qëllime të këqija

**shpirtligësi** - ai i cili i bën keq dikujt

**famëkeq** – ai për të cilin flasin keq, prej të cilit frikëson me pamjen e tij dhe veprat e tij

**qëllim keq** – qëllime të këqija (kundër të mirës)

smirë, dashaligësi - disponim i fuqishëm me qëllime të këqija drejtuar dikujt, armiqësi, dëshirë për të lënduar.

**krim** - shkelje e rëndë, veprim kriminal (veçanërisht drejtuar qenies së gjallë) shkelje e rëndë e ligjeve dhe rregullave të shoqërisë, implementimin e të cilave kjo shoqëri e llogaritet të obligueshëm për ekzistimin e saj.

# SHËN KLIMENTI I OHRIT - MËSUESI YNË MORAL

Etika u tregon njerëzve se si duhet të sillen, veçanërisht u drejtohet të rinjve që të orientohen drejt, të kenë sjellje dhe të kenë kujdes. Etika dëshiron të jetë e afërt me shpirtin e njeriut, mësimet e saj janë burime të moralit të mirë. Ajo shprehon që do të mësohen idetë etike, që do të kuptohen dhe të pranohen këshillat etike.

Fuqinë më të madhe etike për ne këtu në Maqedoni e kanë porositë e Shën Klimentit të Ohrit. Normat të cilat i ka treguar ai janë bazë e etikës sonë, ato na mësojnë për më të mirën dhe kërkojnë nga ne të sillemi në mënyrë të mençur. Dy elementet themelore etike të Shën Klimentit të Ohrit janë largimi nga e keqja dhe të vepruarit mirë. Ky është qëllimi i etikës – të mos bëjmë keq - dhe anasjelltas të duhet e mira dhe të veprohet mirë.



## LARGOHU NGA E KEQJA

Nga e keqja sigurisht që duhet të largohemi për arsye se është e orientuar në lëndimin e njerëzve. Nga e keqja dëmtohet edhe vetë individi i cili e dëshiron të keqën, vepron keq ai- i cili bën keq. Ai i mbështet veprimet e këqija mes njerëzve.

E keqja është e orientuar drejt shkatërrimit, lëndimit, krijimit të dëmeve, shqetësimit. Ai i cili ndjek të keqen, ka qëllime negative, është lakmues, vetëm dëshiron diçka, në fakt gjërat që i përkasin dikujt tjetër. Ai nuk respekton të drejtën e njeriut për të jetuar në lumturi. Ai nuk mendon për të afërmit e tij, nuk i do ata, ndaj tyre nuk silllet mirë. Veprimet e tij janë të padrejta, nuk kontrollon qëllimet e tij dhe me pafytyrësi drejtohet drejt kryerjes së qëllimit të keq. Ai nuk respekton etikën, nuk dëshiron asnjërin dhe nuk ka kujdes për veprimet e tij.

## VEPRO MIRË

Shën Klimenti i Ohrit thotë:

“Largohu prej të keqes dhe vepro mirë” ky është mësim jo vetëm që të shmangemi prej veprave të këqija, por edhe kërkesë që të veprohet mirë. Shmangia nga e keqja duhet të përmbushet me vepra të mira. Ana e vërtetë e njerëzimit është - vepra e mirë. Për këtë janë të nevojshme mendime të mira, fjalë të mira dhe vepra të mira. E mira është fuqia e jetës, ajo e ndërton dhe e përparon jetën. Nga e keqja pason vuajtja, shkatërrimi dhe vdekja. E mira ndërton jetën, kjo është rruga e vërtetë - veprimet e mira i bëjnë mirë të tjerëve dhe vetë atij që bën mirë. Mirësia dhe bukuria shkojnë shohin të bukur. Cili zgjedh të keqen, bashkë. Cili është i mirë, njerëzit e është i keq dhe nuk pëlqehet.

## ETIKA DHE MORALI

Ai nuk vendos kufij në sjelljet e tij, nuk vepron njerëzisht, tërë kohën lëndon dhe kënaqet me veprat e këqija.

Shën Klimenti i Ohrit flet kundër të keqes, njerëzit normal shmangen prej të keqes, dëshirojnë të largohen nga e keqja dhe vetë ata nuk veprojnë keq. Shmangia e tyre nga e keqja është gjëja e parë që duhet mësuar, e rëndësishme për secilin mësues, për jetën e secilit njeri, i cili e ndjek rrugën e tij jetësore.

Për këtë arsye duhet dëgjuar Shën Klimentin, i cili qysh në fillet e historisë sonë tregon fshehtësitë e etikës dhe rrugën keqja është ajo e vërteta - kurse e drejtë të jetës. Largimi nga e veprat e mira edhe më e vërteta. E mira duhet gjithmonë të duhet të bëhet dhe të dallohet tek ne dhe tek të tjerët.

Mësuesi ynë më i njohur **Shën Klimenti i Ohrit** (830?-916) ka qenë nxënësi më i mirë i filozofëve tanë të mëdhenj Kirili dhe Metodi. Ky nxënës i talentuar është dijetari më i madh në Maqedoni, ka formuar universitetin e parë në Ohër, ka formuar alfabetin cirilik, ka shkruar biografinë e mësuesve të tij, ka qenë i njohur si muzikant, agronom, mjek, predikues. Ai është maqedonasi i parë i cili ka qenë peshkop dhe shkrimtar i madh. Shën Klimenti i Ohrit ka qenë mësues i shkëlqyeshëm dhe është etiku ynë më i njohur.

Fjalët dhe veprat e Shën Klimentit janë të orientuara në përparimin e sjelljes së njeriut "Ai ka kërkuar me butësi dhe pa gënjeshtër, me dashuri të vërtetë të respektohem njëri me tjetrin". Ai ka vendosur detyra të rëndësishme dhe gara, të tejkalojmë njëri-tjetrin me mirësi dhe prej sot "të mundohemi për vepra të mira". Shën Klimenti i Ohrit është miku më i mirë për shkak se dëshira e tij është të bëhemi njerëz të mirë.



### LARGOHU NGA E KEQJA DHE VEPRO MIRË

*Shën Klimenti i Ohrit*

Bisedoni për Plaoshnikun, ku gjendet Universiteti ynë i parë dhe varri i Shën Klimentit të Ohrit. Pse janë të rëndësishme veprat e tij, pse ne edhe sot duhet të respektojmë dhe dëgjojmë Shën Klimentin e Ohrit?



#### DUHET

- + largohu nga e keqja
- + vepro mirë
- + duaj njerëzit dhe natyrën



#### NUK DUHET

- të duhet e keqja
- të mos bëjmë mirë
- të dëmtohen njerëzit dhe natyra



Në fund të kapitullit të parë ETIKA DHE MORALI sjellim disa tekste të bukura etike dhe mësimë. Njerëzit e mençur mendojnë çfarë duhet bërë. Këtë e paraqesin në librat e tyre. Në fillim ata mendojnë për të rinjtë ku paraqiten njohuritë e tyre etike, për shkak se dëshirojnë të përcjellin mësimë të vërteta për sjellje të mirë. Ata janë të sigurt që do të ndihmojnë të rinjtë të kuptojnë çka është e rëndësishme në jetë dhe si duhet vepruar që të jenë mirë ata dhe njerëzit rreth tyre.

## VEPRO MIRË!

**Nënë Tereza** (1910-1997), u lind në Shkup, gjatë jetës së saj ka ndihmuar të varfërit dhe të sëmurët. **Kjo misionare e njohur e kohës sonë** veçon nevojën që njerëzit duhet të udhëhiqen vetëm prej të mirës dhe të jenë të përkushtuar ndaj njeri-tjetrit. Ky tekst quhet LUTJE e Nënë Terezës dhe është një ndër më të njohurat në etikën bashkëkohore. Ajo flet se si skeptikët dhe pesimistët negativisht vlerësojnë njerëzit. Në fakt ajo e paraqet veprën e saj jetësore - e cila i përkushtohet detyrës etike, detyrë e të bërit mirë, gjithmonë dhe me zemër:

“Njeriu nuk është qenie racionale, qenie logjike, ai është qenie egoiste”.

**S’ka rëndësi, duaje!**

“Nëse bën mirë, do të thonë se bën mirë për qëllime personale”.

**S’ka rëndësi. Bëj mirë!**

“Gjatë realizimit të qëllimeve tua - do të takosh miq të rrejshëm dhe armiq publik.”

**S’ka rëndësi, realizoju qëllimet tua!**

“Të mirën që e bën, do të harrohet nesër”

**S’ka rëndësi. Bëj mirë!**

“Për shkak të sinqeritetit dhe drejtësisë do të jesh i lëndueshëm.”

**S’ka rëndësi. Bëhu i sinqertë dhe i drejtë!**

“Ajo që është krijuar me vite të tëra mund të shembet për një moment.”

**S’ka rëndësi. Krij!**

“Nëse ndihmon njerëzit, mund të kalosh keq”

**S’ka rëndësi. Ndihmo!**

“I jep botës më të mirën nga vetvetja, kurse ajo ta kthehet me goditje”

**S’ka rëndësi. Jep më të mirën nga vetvetja!**

**NËSE MENDON DHE VEPRON MIRË,**

**DO TË NDJEHESH MIRË**

**NËSE MENDON DHE VEPRON KEQ**

**DO TË NDJESHESH KEQ**

*thënie etike indiane*

## DUAJE FQINJIN!

Shkencëtari ynë më i njohur **Blazhe Koneski** zbuloi dhe shpjegoi **PËRMBLEDHJËN E TIKVESHIT** - vepër kjo e krijuar në shekullin XVI në rajonin e Tikvesh, e cila përmban mësimet etike - si tregime për personalitetet nga Bibla ose tregime popullore ku kafshët tregojnë sjellje etike:



“Lejleku është zog i butë. Kur bën folenë, kërkon vend dhe kujdeset për gjithçka rreth tij. Kur sheh diçka krikëllin, që secili përreth tij të shohë dhe të ketë kujdes. Kështu, ai e do Zotin, fqinjët dhe shoqërinë.

Prandaj, shoqëri dhe fqinj dëgjoni - çfarë dashurie kanë zogjtë, dashuri të tillë të keni edhe ju ndaj të afërmit tuaj. Ta konsideroni të afërmin sikur vetën tuaj! Sikur që e do Zotin, ashtu ta doni edhe fqinjin!



### ËSHTË MIRË

- + të mendoni se çfarë bëni!
- + të veproni mirë!
- + të respektoni njerëzit!



### NUK ËSHTË MIRË

- të veproni pa mend duke mos menduar çka është e drejtë!
- të veproni keq!
- të mos respektohen njerëzit!

## PYETJE DHE PËRSËRITJE

A janë të rëndësishme për njeriun njohuritë nga etika?


Çka na mëson etika?

Njohuritë për të Mirën, të Keqen dhe Moralin a kanë rëndësi për jetën e njeriut?

A duhet njeriu të pajiset me dituri të përgjithshme, prej tyre a nevojiten njohuritë mbi etikën?

A do të ndihmojnë njeriun të zgjedhë rrugën e vërtetë në jetë?

Çka do të ndodhë nëse nuk vepron drejt?



Përshkruani ndonjë vepër morale të një të njohur tuaj që ju ka pëlqyer dhe konsideroni se duhet lavdëruar dhe të tregoni të tjerëve që edhe ata të veprojnë në mënyrë të njëjtë?

Përshkruani ndonjë vepër morale të një të njohur tuaj që nuk ju ka pëlqyer dhe ju ka nevrkosur dhe ju mendoni se duhet kritikuar dhe t'u tregoni të tjerëve që të mos veprojnë në mënyrë të njëjtë?

Çka ka bërë Nëna Tereza, pse kaq shumë duhet dhe lavdërohet në mbarë botën?

Cili është mendimi i Goces dhe a vlen për jetën bashkëkohore?

Cilat janë bazat themelore të mendimit të Shën Klimentit të Ohrit. A mund të jenë elementare për etikën e ditës së sotme, edhe pse është folur para 1100 viteve për të?

Çka thotë Nëna Tereza në lutjen e saj?

Në pjesën e dytë të librit **VLERAT UNIVERSALE ETIKE** jepen sqarime për qëllimet etike të cilat janë të ngjashme në mbarë botën.

Nënkuptohet, secili njeri i ka vlerat e tij dhe gjërat për të cilat mendon që kanë vlerë më të madhe kundrejt gjërave të tjera. Edhe shoqëritë njerëzore kanë vlera të ndryshme të jetës, me mënyrat e saj dhe me kushtet e jetës, me elementet themelore të punës dhe të jetës së pjesëtarëve të tyre, me pasuritë e tyre dhe ambiciet. Por, kjo është kështu sa i përket dallimit të kulturave nacionale, ndërsa në moral, dallimet janë më të vogla sesa dallimet në krijimtarinë kulturore të cilat krijohen dhe shfaqen në mbarë botën.

Kjo është ashtu për shkak se njeriu beson në qëllimet morale të cilat i ka ai/ajo mund të jenë qëllime të çdo individi në botë, kurse normat morale duhet të respektohen nga secili prej nesh. Ky quhet *moral universal*, i ngjashëm me vlerat etike dhe veprimet e njerëzve. Për shembull, te të gjithë popujt e zhvilluar në botë vlerësohet sinqeriteti dhe drejtësia, puna, shpenzimet, ndihma dhe kujdesi për të lënduarit. Po ashtu, nuk pëlqehen dhe kritikohen gënjeshttrat, mashtrimet, dhuna dhe lëndimi i njerëzve.

Në botën moderne njerëzimi është i lidhur tërësisht. Diçka që më parë ka qenë shumë e largët dhe nuk ka pasur mundësi që të arrihet me muaj duke lundruar. Gjatë asaj kohe njerëzit nuk kanë pasur njohuri që ekziston një botë e tillë – tani me aeroplan mund të arrihet për disa orë, kurse televizioni dhe interneti bëjnë lidhje vetëm për disa minuta. Tani në botë shiten të njëjtat prodhime, shumë njerëz braktisin shtëpitë e tyre dhe jetojnë shumë larg nga vendlindja, bëhet e njëjta politikë, anembanë botës këndohen këngë të njëjta dhe shikohen filma të njëjtë, me ngjarje të ngjashme dhe kritika morale dhe lëvdata. Ky quhet globalizim.

Në botën bashkëkohore vlerat etike bëhen të njëjta, të përgjithshme – dhe krijohet **ETIKA UNIVERSALE**, sistem i vetëm etik me normat morale më të mira nga të gjithë popujt, nga të gjitha kohërat e njerëzimit prej etikëve më të dalluar.

## ETIKA NË BOTË


Çdo njeri, derisa është fëmijë, prindërit i tregojnë se si të veprojnë. Poashtu edhe të parët tanë, gjyshi dhe gjyshja, nëse janë të gjallë dhe jetojnë në afërsi këshillojnë pasardhësit e tyre me këshillat më të mira, mësohen në çka duhet pasur kujdes dhe si të mos lëndohen të tjerët duke vepruar keq. Të rinjtë poashtu të njëjtën e dëgjojnë prej mësuesve të tyre në çerdhe dhe në shkollë. Duke shikuar televizionin ata mund të shohin edhe njerëz që bëjnë keq dhe të kuptojnë që nuk duhet vepruar në këtë mënyrë.

Nëse vërehet aty ndonjë vepër e mirë, edhe atyre do t'ju kujtohet se duhet vepruar në mënyrë të njëjtë. Edhe ky libër dëshiron të mësojë fëmijët për veprimet më të mira. Në shumë filma dhe diskutime bisedohet për të mirën dhe për të keqën, për domosdonë e të vepruarit mirë dhe sa është e padobishme të bërit keq. Kur lexojnë libra dhe shohin filma, të rinjtë mendojnë se çka kanë kuptuar prej tyre dhe orientohen për mirësi kundër së keqes.

Kështu secili individ i ri do të rritet dhe do të vijë koha të vendos çka i pëlqen dhe çka do të veprojnë. Gjithashtu, në mënyrë racionale do të zbulojë çka është e keqja dhe do të largohet nga ky veprim, dhe të tjerëve do t'u tregojë që të mos bëjë vepra të tilla.

Kur njeriu e zgjedh të mirën, ai është i sigurt që të gjithë njerëzit e llogarisin këtë vendim si të mirë dhe dëshirojnë të veprojnë në mënyrë të njëjtë. Kjo quhet **etikë e përgjithshme**, moral i tërë njerëzimit, ka dallime të vogla prej kontinenteve dhe racave të ndryshme të njerëzve, mirëpo prapë se prapë këto dallime nuk janë edhe aq të mëdha – e mira është e mirë, kudo që jemi në botë, sikurse që është edhe e keqja.

Mendimi i mirë, fjala e mirë dhe veprimet e mira janë të mira në secilin vend. Mendimi i keq, fjala e keqe dhe sjelljet negative të cilat lëndojnë njerëzit janë të këqija gjithkund. Për këtë shkak secili duhet të bëjë llogaritë e tij dhe të sillet në mënyrë të drejtë. Morali lidhet me mendimin, vendimin dhe veprimin. Etika/morali realizohen në katër forma dhe hapa, të lidhur njëri me tjetrin - ideali, vlera, norma dhe vepra.





**Ideali** është kuptimi të cilin individi e ka zbuluar dhe e ka pranuar si qëllim të fundit të ekzistimit dhe veprimit. Ideali tërheq në jetë, si dritë që tregon rrugën. Ideali është më shumë mirësi. Çka është më e rëndësishmja, ai është burim i vlerave të tjera dhe jep fuqi.

**Vlera** është e tërë ajo që vlen sipas orientimit etik. Janë paramendime dhe qëllime për të cilat njeriu mendon se janë të drejta, pëlqehen, janë të nevojshme dhe i përcjell gjatë jetës dhe në veprimtarinë e tij. Vlera është vendim i njeriut për të cilin mendon që është i mirë dhe paraqet largimin e tij prej asaj që mendon se është e keqe.

**Normat** është *urdhër* etik, vlerë etike në formë që tregon çka duhet bërë dhe çka nuk duhet bërë. Normat janë kërkesa për veprim, përshkrim direkt i vlerave të mira dhe tregues se çfarë duhet bërë, përkatësisht thënie për atë që nuk ka vlera dhe kërkohet të mos bëhet.

**Hapat** veprat janë në fakt njeriu çfarë *bën*. Paraqet ringjallje të vlerave dhe realizimin e normave. Hapat inspirohen prej qëndrimit etik të individit, të grupeve ose të një periudhe. Vepra është vepër përfundimtare e paramendimeve, qëllimeve etike. Morali në fakt ekziston për njerëzit që të veprojnë mirë.

Një karakteristikë e njëjtë etike mund të shfrytëzohet për përcaktimin e të gjitha niveleve etike, mendimet dhe veprimet: për shembull **NDERSHMËRIA**. Ajo është ideal i moralit - etikë perfekte qëllim i jetës; *vlerë* - zgjedhja ime/jonë për atë që vërtet është e rëndësishme; *normë* - kërkesa dhe udhërrëfyes i veprimeve, çfarë doemos duhet të bëhet dhe çka nuk duhet shmangur: Bëhu i ndershëm! Duhet gjithmonë të jemi të ndershëm ndaj gjithkujt dhe për gjithçka!; *veprim* - sjellje e mirë, që është pasqyrim i vetëdijes sime/sonë morale, të vlerave të zgjedhura, të normave të vendosura dhe të pranuar mirë, si dhe i kulturës personale dhe të përgjithshme.

**NOCIONET  
KRYESORE  
ETIKE**

**SHKËLQYESHËM -**

fjalë që buron nga fjala **shkëlqim**, që do të thotë shkëlqen, veçori apo vlerësim personal për dikë, e nga ana tjetër vlerësim tejet i mirë – nocioni flet për kualitet të lartë, për diçka që dallohet dhe pëlqehet, e klasës së parë, më e mira, që duhet lavdëruar, kurse i shkëlqyeshëm është ai i cili ka kualitet të madh, me më të mirat me veçori të pa përshkruara, i cili duhet marrë si shembull.

**SEMBULL -**

individ i mirë, sjellje e mirë dhe vepër e mirë, që përmenden si rrugë që duhet ndjekur dhe përkrahur

## POPAJI - HERO I MIRË

Njerëzit kanë krijuar vepra me heronj vizatimorë, të cilët bëjnë mirë, kurse disa janë personazhe kryesorë të filmave dhe të tregimeve të ilustruara, hero i veçantë i veprimeve të mira është **Marinari Popaj**. Ai i do njerëzit dhe i mbron ata dhe zonjat prej personave të këqij, të cilët dëshirojnë të lëndojnë dhe t'i zënë ata. Popaji u kundërvihet atyre, të cilët kanë qëllime të këqija dhe ushtrojnë dhunë. Në fakt, për forcën e keqe gjithmonë gjendet një forcë e mirë, e cila do t'i ngadhënjejë ata të cilët kanë qëllime të këqija dhe do të lirohen ata të cilët vuajnë.



Popaji, poashtu porositi fëmijët se ata duhet që të ushqehen vetëm me **ushqim të shëndetshëm**. Ai ushqehet me spinaq dhe fiton forcë. Secili duhet të ushqehet me ushqim të mirë - mollë dhe fruta të tjera, specia, kastravecë, mish dhe gjithçka që bëhet në shtëpi - kështu që fëmija të jetë i shëndoshë dhe i fortë.

### ✓ GJITHMONË

- + keni kujdes se çfarë bëni!
- + kryeni detyrat!
- + ndihmoni atë i cili ka nevojë për ndihmë!

### ✗ ASNJËHERË

- mos u bëni të pakujdesshëm!
- mos iu shmangni detyrave!
- mos refuzoni që të ndihmoni!



Rrethoni atë që mendoni se është e mirë e përgjithshme, dhe nënvizoni atë që mendoni se është e keqe dhe lëndon të tjerët.

- |                      |                                   |
|----------------------|-----------------------------------|
| - rrahje             | - mbajtja e librave               |
| - mësim              | - komunikimi                      |
| - cigare             | - ushqimi                         |
| - shpenzim           | - frikësimi i të tjerëve          |
| - ndihma në shtëpi   | - sjellje e këndshme              |
| - sjellje e ndershme | - flasim të vërtetën              |
| - thënie gënjeshtre  | - pakujdesia ku hedhim mbeturinat |

Mendoni pastaj me mendjen tuaj, ose diskutoni me shokët tuaj të afërt për përcaktimin tuaj të mirë dhe të keq - është mirë të bëhen vepra të tilla të mira dhe pse është keq të bëhen vepra të këqija?

## NDERSHMËRIA ËSHTË MIRËSIA MË E MADHE

Në etikë nuk kemi vetëm një përparësi. Tek njeriu kemi mirësi të ndryshme - Maturi, Dashuri, Ndhimë, Bashkëpunim, Shoqëri, Punë, Respektim i të tjerëve, Trimëri, Dashuri ndaj së vërtetës, Kujdesi të mos lëndojmë dhe shumë të tjera. Jeta është e mbushur me mirësi që duhet të bëhen dhe të mos shmangen. Duhet vetëm të ikim prej të keqes, mirësia duhet të ndiqet dhe të realizohet. Secila nga mirësitë është e rëndësishme për vetë individin, si edhe për ata përreth tij.

Mirëpo, ndonjëri mund të insistojë dhe të kërkojë bazën e mirësisë. Për ekzistimin dhe përparimin e botës, më e



rëndësishme është paqja, kurse me të mosdhuana dhe bashkëpunimi. Për marrëdhëniet midis njerëzve mirësia më e mirë është dashuria, e cila mundëson që të duhemi mes veti, të respektojmë të afërmit dhe të lidhemi. Për punën më e rëndësishme është detyra, e cila na mëson që gjithsesi duhet t'i kryejmë obligimet. Sido që të jetë, është një vlerë morale e cila nevojitet për njerëzit dhe

është forma më e përhapur morale në mbarë botën. Kjo është ndershmëria. Ajo flet për gjërat të cilat priten prej moralit, njeriut dhe çka vlerësohet më shumë në sjelljet e tij.

Ndershmëria është përmbledhje e mirësive të ndryshme. Njeriu i ndershëm kujdeset të veprojë mirë dhe në çdo moment kujdeset për obligimet e tij dhe nuk i harron. Ai/ajo moralisht vepron me vullnet, pa detyrim duke mos kërkuar shpërblim për veprat e mira, për shkak se kupton që sjellja e tij morale e mirë, është personalisht për të, për të tjerët dhe tërë shoqërinë.

Secili ka nevojë për ndershmëri nga njerëzit tjerë dhe secili duhet të mundohet të jetë i ndershëm, të veprojë mirë dhe drejt. Të gjithë njerëzit i vlerësojnë ata të cilët janë të ndershëm në jetë dhe në punë.

## ÇFARË ËSHTË NDRERSHMËRIA NË RASTE TË NDRYSHME

- **Individ i ndershëm** - gjithmonë kujdeset për moralin, nuk gënjen, nuk vjedh, mundohet të punojë mirë, obligimet i kryen me rregull dhe paguan faturat, nuk ofendon njerëz tjerë, mund të mbështetet secili në të, për shkak se njerëzit e dinë se asnjëherë nuk dorëzohet.
- **Prindër të ndershëm** - mendojnë para se gjithash për familjen dhe fëmijët e tyre dhe kujdesen të mundësojnë jetë më të mirë për familjen, kurse fëmijët të mësojnë dhe të përparojnë.
- **Sportist i ndershëm** - luan lojë - të drejtë, respekton kundërshtarit dhe luan sipas rregullave, nuk bënë gabime dhe nuk shfrytëzon doping për mashtrime në gara.
- **Gjyqtar i ndershëm** - gjykon sipas ligjit, nuk dallon asnjërin, është shembull i gjyqimit të rregullt.
- **Tregtar i ndershëm** - tregon të vërtetën për mallin e tij, nuk mashtron asnjërin, pagesën e ka të saktë dhe e kthen kusurin.
- **Fëmijë i ndershëm** - dëshiron të mirën, respekton më të moshuarit dhe i do moshatarët e tij, mëson me vullnet dhe mundohet të përparojë në dituri dhe në sport, asnjëherë nuk gënjen dhe gjithmonë ndihmon kur ka mundësi.
- **Ndershmëri ndaj vetvetes** - dëshirë e sinqertë që njeriu të vërejë të vërtetën dhe të jetë objektiv, të mos mashtrohet me vetveten për gjendjen e tij, detyrat dhe shpresat të mos shmangen dhe asnjëherë të mos vë baste si dhe asnjëherë të mos përdor drogë (të cilat e çojnë individin drejt humbjes dhe mashtrimit).



Mendoni për ndershmërinë si mirësi shumë të rëndësishme, vlerësoni çka është e mirë – keqe në sjelljen e këtyre personave dhe përgjigjuni shkurtimisht me shkrim.

-Keni vërejtur që një tregtar nuk respekton konsumatorët, jep mall të skaduar dhe nuk e kthen kusurin - Çka mendoni, pse nuk është tregtar i mirë dhe njeri i mirë?

---

---

-Keni dëgjuar për ndonjë fqinj, ose njeri tjetër, që tërë kohën shkon në bastore, vë baste dhe nuk ka të holla që të paguajë obligimet. - Çka mendoni, ky njeri a është i ndershëm, a mund të kujdeset për nevojat e familjes së tij?

---

---



- Keni parë që një mësues, i cili nuk i respekton të gjithë fëmijët njësoj dhe nuk përkujdeset njësoj për të gjithë nxënësit, poashtu nuk vlerëson drejtë. - Çka mendoni, a është ky mësues i mirë, a bën edukimin e nxënësve njësoj dhe a do të ishit ju mësues i tillë kur do të rriteni?

---

---

---

- Një shok në shkollë është i madh dhe i paedukuar, maltreton shokët, i rrah fëmijët e dobët, ua merr ushqimin dhe të hollat atyre. - Çka mendoni, a është ky nxënës i ndershëm, a ka të drejtë të sillet kështu me shokët e shkollës, a guxon të grabitë?

---

---

---

- Ju jeni të urtë, dëgjoni prindërit, i kryeni obligimet në shtëpi dhe në shkollë, mundoheni të përparoni. - Çka mendoni, a jeni të ndershëm, a është më mirë të veproni kështu, apo ndoshta do të hiqni dorë prej sjelljes së këtillë?

---

---

---



#### **DUHET**

- + të jemi gjithmonë të ndershëm!
- + të mos gënjejmë!
- + secili të dijë çka duhet bërë dhe si të veprojë!



#### **NUK DUHET**

- të jemi të pandershëm!
- të gënjejmë!
- të lihen obligimet duke mos bërë mirë!

## **GJTHMONË THUAJE TË VËRTETËN!**

Etika ka të bëjë me mirësinë e njerëzve. Çdo njeri duhet të mundohet të bëhet më i mirë, t'i zgjerojë dituritë e tij dhe të veprojë më mirë dhe më suksesshëm. Idealet që i përmend etika, të cilat kanë qenë gjëja më e rëndësishme dhe më e nevojshme për njerëzimin janë: E mira, E vërteta dhe E bukura.

Këto tri vlera kanë të bëjnë me *krijimtarinë* njerëzore, e cila vlerësohet si e bukur ose e shëmtuar; me *sjelljen* e njeriut që mund të jetë e mirë ose e keqe, dhe për *njohuritë* njerëzore për të cilat thelbësore është nëse ato janë të vërteta apo të pavërteta.

E vërtetë është kur njohuritë janë të sakta, ashtu siç është realiteti. Në këtë rast këto janë në harmoni të ndërsjellë dhe kemi dobi gjatë shfrytëzimit të tyre. Njeriu ka shumë nevojë për të vërtetën, që të veprojë drejt dhe të jetojë mirë,

## VLERAT UNIVERSALE ETIKE

të ketë mirëkuptim me njerëzit, të mos gabojë dhe të mos bëjë dëme, të mos bëjë keq si shkak i mos njohurive.

Prandaj duhet të synojmë drejt të vërtetës. Dashuria për të vërtetën është prej mirësive më të mëdha. Ajo thotë:

### **Gjithmonë kërkoje dhe thuaje të vërtetën!**

Por, te njerëzit është shumë e përhapur gënjeshtria, Ajo është e kundërta e së vërtetës. **Prej saj largohen dhe turpërohen njerëzit e drejtë.** Kurse i pandershmi ikën nga e vërteta. Shumica nuk mund ta shohin të vërtetën në sy, i frikësohen realitetit. Me gënjeshtria dëshirojnë të fshehin gjendjen e tyre. Për shkak se gënjeshtria është shprehje e mundimit të brendshëm të individit, i cili ikën prej realitetit drejt ëndrrave jo-reale.

Gënjeshtria ka për qëllim që të shtrembërojë të vërtetën, të mashtrohet ndonjëri, futje në besime ose vepra të gabueshme, të iniciojë veprim të cilin në fakt nuk do ta kishit bërë.

Me gënjeshtren, gënjeshtari realizon planet e tij, bën ngatërresa mes njerëzve dhe ofendon. Të gënjerit është diçka shumë e keqe.

Shkuarja drejt së vërtetës është një ndër drejtimet themelore pozitive të etikës - kurse gënjeshtria është e bazuar në veprim negativ, i cili është në zemrën e egoizmit, varësisë, të keqes, armiqësisë. Nuk ka gënjeshtër të mirë, secila gënjeshtër është e keqe dhe i bënë keq njeriut. Vetëm për të vërtetën ka nevojë njeriu dhe i ndihmon atij që të ketë sukses në jetë. **Respektimi i së vërtetës është detyra më e rëndësishme e njerëzimit dhe për secilin njeri.**



**Gandi** (1869-1948) është një prej personaliteteve më të njohura të periudhës moderne – në vitin 2000 e kanë vlerësuar si politikanin më të rëndësishëm të shekullit XX. U lind në Indi, ka mësuar drejtësinë në Angli dhe ka qenë avokat në Afrikën Jugore. Është kthyer në Indi dhe ka organizuar kryengritje për çlirim prej okupatorëve kolonialistë. Ka përdorë idetë etike dhe ka zhvilluar lëvizje të veçantë të kryengritjes pa dhunë. Prej burgut Gandhi ka shkruar letra për opinion, në të cilat bashkatdhetarëve të tij u ka sqaruar që mirësia më e mirë është e vërteta dhe dëshira për të vërtetën (Satjagraha). Kur do të kuptohet se cila është e vërteta, edhe populli do të çlirohet dhe do të fitojë. Indianët e kanë quajtur këtë mësues **Mahatma**, që do të thotë „i madh,, shpirti më i mirë. Më vitin 1947 India u çlirua kurse Gandhi ishte Presidenti i parë.

# E VËRTETA EKZISTON, VETËM GËNJESHTRA MUND TË SHPIKET

Zhorzh Brak

Diskutoni me shokët tuaj për thënien e  
piktorit të njohur francez

## ÇKA DO TË MENDOSH E DO TË THUASH?



- Kur nuk i keni bërë detyrat e shtëpisë - a mendoni se keni vepruar mirë dhe do të gënjeni arsimtarët, duke u arsyetuar - ose do të jeni të vetëdijshëm për gabimin që e keni bërë dhe do të kërkoji falje (pastaj nuk do të përsëritni gabimin e njëjtë)?
- Kur keni bërë ndonjë dëm në shkollë ose në shtëpi – a do të jeni indiferent dhe do të gënjeni se nuk e keni bërë këtë ose pa arsye do të fajësoni dikë tjetër, ose do të pranoni para opinionit dhe do të mundoheni të përmirësoni gabimi?
- Kur ndonjëri ju gënjen dhe ti e kupton këtë - a e arsyeton se ju ka mashtruar, thua në vete ndoshta edhe ju do të gënjeni kur të keni mundësi – ose nuk do të pëlqejë dhe do t'i premtori vetes që asnjëherë nuk do të përsëritni gabimin e tillë, nuk do të gënjeni ndonjërin?
- Kur bëni veprim të palejuar në lojë, dhe ndonjëri ka vërejtur këtë - a do të vazhdoni kinse asgjë nuk ka ndodhur dhe do të thoni në vete mirë që nuk të kanë parë dhe mund të fitojë më lehtë - ose do të pranoni që keni gabuar dhe dëshironi të fitoni në mënyrë të rregullt (fer play), por edhe nëse keni humbur do të thuash ka ditë tjera për lojë?
- Kur prej arkës do t'ju kthejnë më shumë të holla se sa duhet - a gëzoheni se keni fituar në mënyrë të padrejtë (duke thënë me vete: le të mendojnë ata çfarë të bëjnë, nuk do të tregoni asgjë, dhe duke u fshehur shpejtë e shpejtë do të largoheni - ose do ta paraqitni gabimin dhe do të kërkonit të kontrollojnë edhe një herë llogarinë, kurse
- në lëvdatat e dhëna do të përgjigjeni s'ka përse?

### GËNJESHTRA ËSHTË MANGËSIA MË E MADHE DHE GABIMI MË I MADH

*Nënë Tereza*



#### E VLEFSHME

- + të flitet e vërteta
- + të mos fshehim gabimet
- + të jemi miq me të tjerët
- + të bashkëpunohet



#### E PAVLEVSHME

- të thuhet gënjeshtër
- të fshihen veprat e këqija dhe gabimet
- të planifikohet diçka e keqe kundër ndonjërit
- të anulohet bashkëpunimi dhe ndihma

## DREJTËSIA ËSHTË FORCA E TË BARABARTËVE

Në etikë e rëndësishme është sjellja e njeriut dhe kujdesi i tij për vetveten, kujdesi për natyrën dhe shëndetin, respekti ndaj gjërave materiale dhe punës. Bazike është edhe sjellja midis njerëzve – respekti i tyre i ndërsjellë, ndihma dhe bashkëpunimi si dhe realizimi i qëllimeve të punojnë me sukses dhe të zhvillohet shoqëria e tyre, gjë e cila të gjithëve do t'u sillte dobi, ndërsa në shoqëri të mirë do të ndjehen mirë të jetojnë dhe veprojnë. Kujdesi për të mirën e çdo njeriu dhe tërë shoqërisë quhet Drejtësi.

Drejtësia është sjellje me të cilën njeriu tregon se të gjithë njerëzit i konsideron të barabartë, që respekton dhe realizon të drejtën dhe askujt nuk i jep përparësi e që mund ta lëndojë tjetrin. Kjo është të kuptuarit në mënyrë serioze dhe objektive pozitën e njerëzve, të të gjitha çështjeve të jetës së njeriut. Njeriu i drejtë i kupton gjërat ashtu siç janë, askujt nuk ia bën qejfin, nuk bën dallime dhe nuk i konsideron më të ulët, por përkundrazi në çdo rast i konsideron si të barabartë, kurse për secilin njeri dhe vepër bazohet në moralin e mirë.

Drejtësia është shumë e rëndësishme për njerëzit. Nëse përjetojnë padrejtësi, ata janë të pikëlluar dhe të hidhëruar, prandaj bëjnë keq dhe hakmerren për shkak të veprës negative. Nëse vazhdimisht ndjehen të fyer, mund të llogaritin që jeta nuk ia vlen dhe nuk ka pse të mundohen të japin më të mirën prej vetes. Por nëse përjetojnë drejtësi, atëherë e pëlqejnë jetën dhe e durojnë kritikën nëse gabojnë, dhe përmirësohen, përkatësisht u ndihmojnë atyre që vuajnë, që të kuptojnë se jetojnë bashkë me njerëzit dhe relacionet e tyre do të jenë të drejta. Me një fjalë angleze mund të emërohet sjellje fer, respektim i rregullt i tjetrit, largimi prej veprave kundërvajtëse, veprimi sipas rregullave të pranuar.

Më e rëndësishme është drejtësia e atyre që janë më lart në kuptimin social - prindërit, udhëheqësit, mësuesit, gjyqtarët. Ata nuk duhet të gabojnë dhe të sillen në mënyrë të padrejtë, të dallohet ai që gabon, ose të lëndohet njeriu i cili është i drejtë. Drejtësia është forcë e njerëzve të barabartë, është shprehje e lirisë, e rregullave dhe zemërgjerësisë të individit në një shoqëri.

**Martin Luter King** (1929-1968) është personalitet më i njohur i kohës moderne. Ky prift zezak u ka tre-guar amerikanëve që duhet të mësojnë së njerëzit janë të njëjtë dhe kanë të drejtën për të jetuar, për t'u shkolluar dhe të drejtën kulturore. Kjo është drejtësi bashkëkohore për shkak se në atë kohë ka ekzistuar dallimi midis njerëzve në aspekt të ngjyrës.

King ka mbajtur fjalime kundër dallimeve racore dhe kundër shtypjeve ndaj të dobëtëve. Besonte që për të jetuar është e rëndësishme drejtësia. Kur fliste, shpesh thoshte: „Kam një ëndërr... dhe ka shtuar për atë se shpreson që kjo do të përmirësohet dhe asnjëherë të mos përsëritet. Më shumë ka folur për ëndrrën e tij - paqen, të mos ketë varfëri, njerëzit midis tyre të respektohen dhe të bashkëpunojnë. King ka mësuar që urrejtja nuk mund të fitohet me urrejtje, kështu që kjo veti e keqe mund të fitohet vetëm me dashuri. Në SHBA, 15 janari, ditëlindja e Martin Kingut (është vrasë prej njerëzve të këqij gjatë një atentati), përkujtohet si ditë e barazisë racore dhe e drejtësisë.



## SI DO TË GJYKONI?

- Kur para teje është lënë të vendosni cili ka të drejtë, një djalë apo një vajzë - a do të gjykonit sipas gjinisë së tyre, ose do të mundoheni të kuptoni të vërtetën dhe asnjëri të mos ketë përparësi të paarsyeshme.
- Kur ndonjëri nuk i kryen obligimet e shkollës (nuk i bën detyrat, nuk kujdeset për klasën...) kurse atë e keni të afërt për shkak se jetoni në ndërtesë të njëjtë, jeni fa-refis dhe shpesh luani bashkë - a do ta mbronit, edhe pse jeni të vetëdijshëm se gabon, ose do t'i tregoni (para të tjerëve) që ka gabuar dhe që asnjëri nuk guxon të dorëzohet përpara obligimeve të veta.
- Nëse dikush ngucet dhe i shkakton dëme pronës, moshatarëve ose njerëzve të tjerë – a bëhesh se nuk e sheh, madje edhe e arsyeton, apo vlerëson objektivisht dhe je në anën e të dëmtuarit?
- Nëse ke gabuar diçka dhe të qortojnë - a mundohesh të shohësh çfarë ka ndodhur dhe se i ke shkelur rregullat, e nëse je fajtor, kërkon falje dhe e përmirëson gabimin, ose vetëm mbrohesh dhe pohon se askush nuk ka të drejtë të të thotë se çfarë duhet të bësh?
- A kërkon të ketë drejtësi dhe të sillen fer ndaj teje - ndërsa ti vetë, nga ana tjetër, nuk kujdesesh për këtë dhe të tjerëve u bën padrejtësi?
- A i respekton rregullat dhe partnerin gjatë lojërave në sport - ose sheh të bësh shkelje (asnjëri të mos shohë) shtyhesh dhe lëndon kundërshtarët tuaj?

## NËSE HUMBET DREJTËSIA JETA E NJERIUT HUMB VLERAT

*Immanuel Kant*

## VLERAT UNIVERSALE ETIKE

### ✓ E DREJTË

- + Të respektohen ligjet dhe rregullat!
- + Të gjithë të llogariten të njëjtë!
- + Të jemi fer!

### ✗ E PADREJTË

- Të shkelen rregullat dhe ligjet!
- Disa të mbahen më lart se të tjerët!
- Të mos jemi fer!

## PATRIOTIZMI MBRON VENDIN DHE POPULLIN

Çdo njeri është pjesë e disa bashkësive më të mëdha njerëzore - familja, shoqëria e tij, bashkëpunëtorët, vendi (qytet, fshat) rajoni, shteti....Për çdo lidhje sociale ekzistojnë norma morale përkatëse – për punën janë: dëshira për punë, profesionalizmi, durimi, bashkëpunimi, arritja e kualitetit. Janë vlera interesante ndjenja dhe normat morale të patriotizmit, si dhe dashuria dhe respekti për shtetin dhe popullin.

Shteti është shoqëria elementare politike,në të cilën qytetarët e saj janë të mbrojtur me ligj dhe i realizojnë qëllimet e veta politike të bëjnë atë që është e nevojshme për të siguruar jetë, mbrojtje dhe progres për vetën dhe tërë popullsinë. Qëllimi i shtetit është që brenda kufijve të tij, të gjithë njerëzit të ndjehen rehat.

Patriotizmi është normë e vjetër etike, atë e takojmë edhe te popujt antikë, siç janë romakët, ku është dalluar patriotizmi si veti shumë e rëndësishme dhe orientim i individit. Etiku më i njohur romak, Ciceroni - ka krijuar fjalën “moral” si pandan i fjalës helene “etikë” - si konsull, udhëheqës më i lartë në Romë, trimërisht ka qëndruar kundrejt Katilinës, i cili ka dashur ta rrënojë pushtetin dhe të bëjë tollovi në shtet dhe me një varg fjalimesh patriotike e ka mbrojtur demokracinë; prandaj e kanë quajtur „baba i atdheut”, ai i cili për shtetin ka bërë më të mirën.





*Pitu Guli*

Të gjithë popujt kanë heronjtë e tyre, të cilët kanë mbrojtur atdheun. Dashuria, mbrojtja, përparimi i vendit dhe i popullit janë thelbi i patriotizmit. Tek ne janë të njohur patriotët si Krali Marko, Goce Dellçev, Nikolla Karev, Dame Gruev, Pitu Guli i cili ra dëshmorë në vendin e quajtur Meçkin Kamen, duke mbrojtur Republikën e Krushevës. Nga Lufta e Dytë botërore, më të njohur janë Strasho Pinxhur dhe Mirçe Acev, të cilët ranë dëshmorë.

Por patriotizmi nuk u përket vetëm heronjve të luftës. Këtë ndjenjë e ka secili njeri i ndershëm, i cili e do atdheun dhe ia do të mirat atdheut dhe popullit e tij. Sot patriotizmi nuk matet vetëm me rezultatet e luftës, por edhe me kujdesin ndaj natyrës së vendit tënd, e cila duhet të mbrohet dhe të avancohet. Vepra patriotike janë edhe veprat e mira, mësimet, lartësimi dhe puna e përkushtuar, të jemi të denjë ndaj Atdheut. Patriotike është edhe kujdesi ndaj çdo personi të shtetit tënd.

Patriotizmi krijon emocione të gëzuara kur vendi do të arrijë suksese të mira, ose do të arrihet rezultat i shkëlqyeshëm i ekipeve sportive, ose do të dëgjohet për suksesin e ndonjë individi të aftë nga shteti ynë.

## NOCIONET KRYESORE ETIKE

### PROGRES -

përparimi, arritje e suksesit i cili nuk është arritur deri më sot

- qëllim i lartë në jetën bashkëkohore

**Mustafa Kemal** (1880-1938) u lind në Selanik, babai i tij me prejardhje ka qenë nga rrethi i Dibrës. Ka mësuar në shkollën ushtarake të Manastirit. Ka qenë oficer i shkëlqyeshëm dhe u bë gjeneral (pasha). U shqua në Luftën e Parë botërore, pastaj e përkrahu miratimin e Kushtatutës, me të cilën pushoi së ekzistuari Perandoria Osmane dhe Sulltani. Ka udhëhequr me sukses luftën kundër Greqisë dhe ka siguruar mbijetesën e shtetit të vetëm i quajtur Turqi. U zgjodh President i parë i Turqisë moderne, ai e udhëhoqi shtetin e tij drejt krijimit të kombit dhe të shtetit bashkëkohor, i cili është një ndër shtetet më të forta në botë. Për shkak të veprave patriotike të Kemal-pashës, populli i tij e ka quajtur „baba,, **Ataturk** = „baba i turqve”.



## VLERAT UNIVERSALE ETIKE

Patriotizmi bashkëkohor zgjerohet për shkak të lidhjeve të forta në botë dhe *globalizmit* si bashkim i të gjithë njerëzve dhe shteteve në shoqëri të përbashkët (p.sh. siç është krijimi i Bashkimit Europian dhe ekzistimi i Kombeve të Bashkuara). Patriotizmi nuk do të thotë xhelozia ndaj kualitetit të njerëzve dhe popujve të tjerë apo për shkak të arritjeve të popujve dhe shteteve, por gëzimi i suksesit të përgjithshëm në përgjithësi edhe i tërë njerëzimit. Mirëpo edhe më tej patriotizmi mbetet si lidhje speciale e afërt e njeriut më bashkatdhetarët e tij dhe si emocion i veçantë i zemrës kur shohim se si valëvitet flamuri.



**Xhon Kenedi** (1917-1963), hero lufte në Luftën e Dytë botërore (në të cilën ra dëshmor edhe vëllai i tij më i madh) udhëhoqi shtetin e tij drejt zhvillimit të ri, drejt të drejtave njerëzore, kulturës, shkollimit, shkencës dhe eksplorimit e gjithësisë, që solli njeriu i parë Nil Armstrong të shkelë në Hënë (1969). Presidenti më i ri i Amerikës (1961) inkurajoi të rinjtë dhe pjesën më të pambrojtur të popullsisë për më shumë guxim dhe shpresë për jetë. Ai e tha mendimin bashkëkohor patriotik:

**MOS PYETNI ÇFARË SHTETI JUAJ MUND TË BËJË PËR JU,  
POR PYETENI VETEN ÇFARË JU MUND TË BËNI PËR SHTETIN TUAJ**



### MIRË ËSHTË

- + Të duhet atdheu!
- + Të jemi qytetar të mirë!
- + Të mësojmë dhe të bëhemi profesional!
- + Të respektohen të gjithë qytetarët në vendin tënd!
- + Të respektohen të gjithë njerëzit në botë!



### NUK ËSHTË MIRË

- Të mos respektohet atdheu!
- Të mos jemi qytetar të mirë!
- Të mos mësohet!
- Të mos respektohen të gjithë qytetarët në vendin tënd!
- Të mos respektohen të gjithë njerëzit në botë!

Mendoni për këto **rekomandime etike**. Çka duhet bërë? Çka nuk duhet bërë? Bisedoni pse janë të propozuara këto rekomandime si **norma etike**.



## ETIKA E SOTME

Etika ka qëllime të njëjta në të gjitha kohërat, por ajo në ndërkohë është edhe e ndryshme. Gjithmonë ka qenë dhe do të jetë elementare ndërkohë që njerëzit të jenë më serioz, të kujdesen për sjelljet e tyre dhe të veprojnë mirë për të afërmit e tyre. Po ashtu njerëzit nga anë të ndryshme të botës dhe gjatë periudhave të ndryshme janë dalluar në bazë të normave që i kanë konsideruar si të rëndësishme dhe për të cilat kanë kërkuar respekt.

Nuk duhet të merremi me të kaluarën dhe të tregojmë cilat kanë qenë dëshirat e njerëzve atëherë. Për shembull, ata kanë qenë të detyruar ta dëgjojnë mbretin, të bëjnë luftëra, kanë pasur mundësi të kenë robër, kanë mundur t'i vrasin ata që nuk kanë menduar njëllë. Kemi me mijëra tradita të këtilla dhe qëllime morale që nuk duhet assesi të bëhen. Por ne **sot kemi norma të vlerave të reja**. Më të rëndësishmet kanë të bëjnë me shëndetin, ekologjinë dhe informatikën.

Më e rëndësishme për njeriun është **SHËNDETI**. Njerëzit gjithmonë kanë dëshiruar shëndet, por në të kaluarën nuk kanë pasur njohuri si ta arrijnë, nuk ka pasur mjek të shkolluar dhe barna për shërim. Sot mjekësia ka përparuar shumë dhe kjo gjë duhet respektuar dhe çmuar. Secili duhet të kujdeset për shëndetin e tij, si dhe shëndetin e të tjerëve. Për këtë duhet të kemi vullnet të mirë dhe të këshillohemi. Për shembull, deri më sot pirja e duhanit është konsideruar si shenjë e të rriturve dhe nuk është quajtur gabim nëse meshkujt në pinë duhan (gratë kanë filluar të pinë duhan në moshë më të rritur). Sot jemi të sigurt dhe thuhet publikisht se pirja e duhanit është e dëmshme dhe negative - duhani krijon shumë probleme shëndetësore, prej tij fillojnë shumë sëmundje dhe prej pirjes së duhanit vdiset me mundime të mëdha. Poashtu, fëmijët nuk guxojnë të pinë alkool dhe kur të rriten duhet të kenë kujdes mos të pinë shumë! Kurse droga assesi kurrë nuk duhet konsumuar!



Duhet të lexohet dhe të mësohet për shëndetin dhe të përcillen njohuritë të cilat ndihmojnë njerëzit në ruajtjen e shëndetit, që të jenë kohë të gjatë të shëndoshë dhe të kënaqen në jetë. Duhet doemos të bëjmë sport! Ky është mësimi themelor i **bioetikës** - e cila na mëson që shëndeti është pasuria më e madhe e njeriut dhe se detyra më e madhe morale e tij përmbushet me sjellje të mira për shëndetin, duke u larguar prej rreziqeve dhe duke ndihmuar njerëzit e tjerë.

Përpiquni të komentoni për  
thënien e mjekut të famshëm

### **BIOETIKA -**

shkencë e re, lidhje e Etikës dhe Biologjisë, qëllimi i së cilës është të analizohen qëllimet dhe sjelljet morale që mund të ndihmojnë në mbrojtjen dhe përparimin e jetës - natyrës, krijesave të gjalla, shëndetit si dhe të shmangen varshmëritë (duhani dhe alkoolizmi), narkomania, dopingun në sport etj.

### **ETIKA EKOLOGJIKE -**

Iloj i ri i etikës, e cila ka të bëjë me kujdesin ndaj ambientit jetësor të njeriut si dhe tërë natyrës.

### **ETIKA HAKERE -**

Iloj i ri i etikës, me të cilën shpjegohen dhe ruhen vlerat elementare të punës me kompjuterë, me qëllim që kompjuteristët të punojnë në mënyrë të drejtë, të mos i dëmtojnë njerëzit e tjerë si dhe të mos zbulojnë sekretet e të tjerëve.

## **NOCIONET KRYESORE ETIKE**



Përveç shëndetit, për njerëzimin është me rëndësi edhe kujdesi për natyrën dhe ambientin jetësor. Shkenca për ambientin jetësor quhet ekologji, ndërsa **ETIKA EKOLOGJIKE** i mëson njerëzit të kujdesen për natyrën, si dhe për të pasur ambient të mirë jetësor. Prej numrit të madh njerëzish dhe teknologjisë së zhvilluar, natyra dhe ambienti jetësorë dëmtohen, ka më pak drurë, ujërat janë më të ndotura, ajri është më i keq, njerëzit bëjnë më tepër mbeturina dhe vështirë ia dalin me fëlliqësirat, klima ndryshon me pasoja të rënda. Mjetet kimike

shkaktojnë sëmundje dhe shumë probleme të tjera jetësore. Armët bërthamore janë shumë të rrezikshme. Njerëzit e mençur janë të brengosur për rreziqet e këtylla dhe sugjerojnë që njerëzit të përmbahen, të veprojnë në mënyrë serioze dhe të kujdesen për natyrën. Ajo është ideja themelore e moralit të sotëm dhe atij të nesërmit.

## **MENDO GLOBALISHT, VEPRO LOKALISHT**


*Motoja themelore e ekologëve*

Sot njerëzit dinë gjithnjë e më shumë. Janë shpikur shumë makineri të cilat e zëvendësojnë punën njerëzore dhe ndihmojnë njerëzit të jetojnë në mënyrë dinamike dhe më mirë. Janë krijuar kompjuterë, makina të cilat e shpejtojnë mendimin. Dituria është baza e zhvillimit të sotëm të njerëzimit dhe lidhshmërisë së tij.

Shkenca për njohuritë njerëzore dhe përhapjen e tyre **INFORMATIKA** jep detyra interesante të etikës. Ajo na mëson se duhet të mësojmë, edhe atë sa më shumë si dhe gjate tërë jetës. Ashtu do të mund t'i kryejmë punët dhe veprat e komplikuar shoqërore. Ajo mundëson të bashkëpunojmë me njerëzit në sfera të ndryshme dhe të bëhemi botë unike. Gjithashtu duhet me mençuri t'i përdorim kompjuterët, të mos biem në mashtrime nëpërmjet tyre dhe ne të mos lëndojmë askënd nëpërmjet kompjuterit. Detyrat e reja të përgjithshme morale të njerëzve janë: mësimi, shkëmbimi i njohurive dhe përdorimi në mënyrë të drejtë i makinave të reja.



Në moral edhe më tej mbeten të rëndësishme ndershmëria, dashamirësia dhe drejtësia, duhet të jemi të mirë, të kujdesshëm dhe të shoqërueshëm ndaj të gjithëve - por gjithsesi duhet ta ruajmë shëndetin, ta duam natyrën dhe ta zhvillojmë ambientin tonë jetësor, si dhe të mësojmë, të zhvillojmë të gjitha njohuritë dhe me mençuri t'i përdorim makinat dhe kompjuterët.



Shkruani hartim të shkurtër për:

- si e ruani shëndetin
- ose si duhet të ruhen natyra dhe ambienti jetësor
- ose si duhet të silleni gjatë punës me kompjuter.

**Rejçëll Karson** (1907-1964) ka merita për lindjen e bioetikës si kujdes për natyrën dhe ambientin e mirë jetësor. Ka shkruar libër të bukur për hapësirat detare dhe shtazët. Është brengosur më tepër pse nuk dëgjohet më cicërima të hareshme zogjsh në mëngjes dhe ka zbuluar se mjetet kimike kundër insekteve i mbysin edhe zogjtë si dhe ndikojnë në gjenet. Në librin „Pranverë e heshtur” (1962), flet për rreziqet nga sjellja e pakujdesshme e njerëzve ndaj natyrës. Presidenti Kenedi themeloi komisionin e parë në botë për identifikimin e problemeve në natyrë (tani quhen *Komitete Etike*),

## VLERAT UNIVERSALE ETIKE

me çka solli kontrollin dhe ndalimin e parë të organizuar shtetëror me materiet e rrezikshme kimike.

Karson ka qenë e mençur, e mirë dhe person i guximshëm. Moralin, guximin dhe patriotizmin i dëshmoi me luftën kundër çmendurive njerëzore dhe krimeve të cilat i shkaktojnë dëme natyrës. Ajo thoshte se është munduar ta shpëtojë bukurinë e botës së gjallë: „Kisha obligim të shenjtë ta bëj atë që mundem - nëse nuk e bëja atë, unë nuk do të mundesha të jem sërish e lumtur në natyrë”.

Karson është iniciator i etikës ekologjike si kujdes i ri mësimor për natyrën dhe shëndetin.



### **NJERIU ËSHTË PJSË E NATYRËS DHE LUFTA E TIJ KUNDËR NATYRËS DOMOSDO ËSHTË LUFTË KUNDËR VETVETES.**

*Rejçell Karson*

Diskutoni me shokët për mendimin e shkrimtares së famshme.



Mendoni dhe përgjigjuni në pyetjet në vazhdim:

- A e ruani shëndetin sa duhet? A keni kujdes çka bëni, a ushqeheni mirë, a pushoni dhe a visheni?
- A shkoni te mjeku kur sëmureni dhe a i dëgjoni këshillat e tij? A mjekoheni nëse jeni të sëmurë apo mendoni se sëmundja vetë do të kalojë?
- A e dini se pirja e duhanit është e dëmshme? A refuzoni të provoni cigare nëse dikush ju detyron? A keni vendosur të mos pini duhan kur të rriteni?
- A e dini se pirja e alkoolit nuk është e mirë? A do të përmbaheni të mos pini alkool?
- A e dini që marrja e drogës shpie në humbje? A

keni vendosur që kurrë të mos provoni drogë?

- A u ndihmoni të tjerëve, me këshilla ose me kujdes, ta ruajnë shëndetin?
- Si duhet të ruhet natyra? A lexoni për ekologjinë? A merrni pjesë në aktivitetet ekologjike? A keni kujdes ku i hidhni mbeturinat? A mbillni drurë?
- A keni provuar tani më të punoni me kompjuter? A do të mësoni të punoni drejtë me kompjuter dhe nëpërmjet tij të mësoheni të komunikoni me njerëz - apo mendoni ta përdorni vetëm për lojëra?
- A mbroheni nga informatat negative dhe nga ofertat e personave të panjohur në Internet?
- A keni dëgjuar se njerëzve mund t'u bëni dëm nëpërmjet internetit - dhe a planifikoni të bëni një të keqe të tillë?



## SOT ËSHTË MIRË

- + Të kujdesemi për shëndetin!
- + Të dëgjohen mjekët!
- + Të ruhet natyra dhe ambienti jetësor!  
Të mësojmë dhe të bëhemi
- + profesionistë!
- + Askush të mos dëmtohet nëpërmjet kompjuterit!



## SOT ËSHTË KEQ

- T'i bëhet dëm shëndetit!
- Të mos dëgjohen mjekët!
- Të mos dëmtohet natyra dhe ambienti jetësor!
- Të lëshohen orët e mësimit
- dhe të mos mësohet!  
T'u bëhet dëm të tjerëve!  
nëpërmjet kompjuterit

Mendoni për këto **rekomandime etike**. Çka duhet të bëhet? Çka nuk duhet të bëhet? Bisedoni pse janë të propozuara si **norma etike**.

## ETIKA UNIVERSALE

Çdo vend ku jetojnë njerëzit ka moralin e vet. Pra edhe familjet dallohen për nga vlerat që i përzgjedhin: disa njerëz duhen, disa çdoherë grinden, disa janë të kursimtarë, disa lehtë shpenzojnë, disa çdoherë janë të qeshur, disa janë të vrenjtur. Këto dallime janë normale dhe ndoshta nga njerëzit duhet të kërkohet të jenë të mirë pikërisht në kuadrin e nevojave dhe karakterit të tyre. Por, për disa gjëra nuk duhet pasur kuptim tek të rinjtë: mirë është të merren me sport, e jo vetëm të rrinë para televizorit dhe të shikojnë sport.



Etika sot është e zgjuar meqë pozita e tanishme e njerëzimit nuk është e mirë. Ajo bën që të ndërrohet kuptimi për moralin si zakonet e njerëzve të një vendi. Natyra është e lënduar dhe njerëzit duhet ta ruajnë. Nuk ka gjasa të përmirësohet gjendja përderisa nuk kujdesen të gjithë. E njëjta është edhe për shëndetin, gjithkush duhet ta ruajë shëndetin sipas njohurive më të reja dhe me metodat bashkëkohore të jetesës dhe mjekimit. Njerëzit nuk duhen të kenë konflikte ndërmjet veti, sepse mund të shkaktojnë dhunë ose – ruaj Zot!- luftë. Ajo do të thotë që mes veti duhen të respektohen dhe të ndihmohen. Domethënë njerëzit tash duhen të kenë moral të ngjashëm, sepse përcaktimet etike të së mirës dhe së keqes janë të njëjta për gjithë botën. Tash nuk mund të themi se ne disi i kuptojmë gjërat dhe prandaj mund të bëjmë diçka që nuk është e mirë për të gjithë ose të mërzisim dikë - por të gjithë duhet të kemi vlera dhe norma morale të njëjta.

Ajo quhet **ETIKË UNIVERSALE** (në gjuhën angleze **etikë globale**), një etikë e përgjithshme për mbarë botën, për të gjithë njerëzit dhe për çdo njeri. Në të, vlerat kryesore janë të njëjta - Paqe, Barazi, Respekt, Miqësi, Bashkëpunim, Ndhimë etj.

## VLERAT UNIVERSALE ETIKE

Këto vlera janë të marra si qëllimet më të mira njerëzore nga e tërë historia dhe mbarë bota. Normat morale në etikën e përgjithshme botërore përmbajnë shembujt më të bukur nga gjithë popujt, si dhe mësimet më kryesore nga njerëzit më të mençur. Etika e re dëshiron të jetë moral për çdo njeri në Tokë, me çka do të bëhet mirë për të gjithë dhe gjithsesi do të shmangen gjërat e këqija.

Nga çdo popull njerëzit mund të mësojnë çka është mirë. Edhe ne mund të propozojmë ideale morale, të cilat mund të ndihmojnë në ndërtimin e një morali të vetëm të mirë të krejt njerëzve. Nënë Tereza nga Shkupi është shembull në mbarë botën për qenie më e lavdishme, e cila dëshiron t'u ndihmojë të mjerëve. Etiku ynë më i njohur Shën Klimenti i Ohrit i ka mësuar njerëzit të garojnë në mirësi dhe ajo duhet të bëhet sjellje shoqërore e çdo njeriu ndaj të afërmeve të vet. Mësimi moral Shën Klimentit mund të jetë parim i përgjithshëm moral për çdo njeri: **LARGOHU NGA E KEQJA DHE BËJ MIRË!**

Qëllimet e mira morale dhe normat njerëzore, të të gjitha epokave dhe kohëve më të urta të njerëzimit duhet të bëhen bazë për një etikë të përgjithshme për të gjithë njerëzit në Tokë, që të jetojnë ndërmjet veti në paqe dhe gjithkush të ndjehet mirë. Në këtë drejtim është kontributi i Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe organizatës së saj për Arsimim, Shkencë dhe Kulturë UNESKO.

**PAQE  
BARAZI  
RESPEKT  
MIQËSI  
BASHKËPUNIM  
NDIHMË**



### SI VEPROJNË POPUJ TË NDRYSHËM

Idetë themelore të etikës janë të njëjta dhe të rëndësishme për të gjithë popujt - Arsye, Maturi, Respekt ndaj tjetrit, Sjellje e mirë. Por, te secili popull ka edhe norma karakteristike:

**Eskimezët** në Veriun e Largët përshëndeten me puqje të hundëve, sepse nga gëzofët e tyre shihen vetëm hunda dhe sytë.

Te **Japonezët** nuk ka qenë e njohur përshëndetja me dorë, por janë përshëndetur me bashkimin e duarve dhe përkulje. Ata domosdo edhe buzëqeshin kur shikojnë dikë.

Etiku më i njohur kinez Konfuqije na mëson se më të vjetrit dhe prindërit duhet të respektohen dhe të ruhen varrezat e tyre. Varri i tij ka mbetur i njëjtë tani 2 500 vjet, ndërsa e ruajnë pasardhësit e tij.

Dy thënie më të njohura të etikës në **Heladën antike** kanë qenë: “Njihe vetveten!” dhe “Ruaje masën!” Të dytën e ka marrë dhe e ka shpjeguar Aristoteli si bazë të etikës, ndërsa të parën, deri në ditët tona e ka përcjellë **mbreti romak** Marko Aurelij me librin e tij të etikës me titull të njëjtë, që është libër i rëndësishëm për moralin për të gjithë të rinjtë në botë.

Karakteristikë e njohur morale e **maqedonasve** ka qenë ndershmëria - kur janë nisur në mërgim, çdokush nga fshatarët ka sjellë nga pak të holla për ndihmë, ndërsa familja ka mbajtur evidencë dhe borxhi iu është kthyer të gjithëve.

**Shqiptarët** kanë traditë të quajtur „besa” - me të cilën obligohen për ta përmbushur premtimin.

**Gjermanët** njihen si populli më i sjellshëm në botë - në çdo fjali me të cilën i drejtohen dikujt, thonë: Urdhëro! ose Urdhëroni! ose Faleminderit!

Në **Amerikë** është traditë të merret ndonjë udhëtarë i cili nuk ka transport dhe të dërgohet më afër vendit për ku është nisur. Kështu ka lindur edhe i ashtuquajtura autostopi.



### **PËR TË GJITHË NJERËZIT ËSHTË MIRË**

+ Të mundohen të bëhen të mirë dhe të bëjnë vepra të mira!

+ Të respektohen ndërmjet veti!

+ Të mos gënjejnë dhe të mos mashtrojnë!



### **TË GJITHË MENDOJNË SE NUK ËSHTË MIRË**

- Të jesh i keq dhe të bëhen vepra të këqija!

- Të mos respektohen të tjerët!

- Të gënjehet dhe të bëhen mashtrime!

Në fund të pjesës së dytë të **Vlerave të përgjithshme të etikës** përsërisim se mbarë bota është e brengosur për atë çka ndodh me natyrën, mundohet me problemet shëndetësore, nuk është e lumtur për shkak të marrëdhënieve të këqija mes njerëzve. Të gjithë propozojnë të respektohet etika, e cila mëson çka është e mirë dhe çka është e keqe, dhe se e mira duhet të ndiqet ndërsa nga e keqja të largohemi. Sot ndërtohet etikë unike për të gjithë njerëzit, e quajtur Etika universale.

Në etiken universale merren parasysh të gjitha njohuritë njerëzore të të gjitha kohërave për atë se si duhen të sillen njerëzit dhe cilat duhen të jenë qëllimet e mira njerëzore. Për këtë duhen të ndiqen mësimet e mendimtarëve më të mëdhenj, etikëve, udhëheqësve fetarë dhe popullorë të të gjithë popujve dhe epokave. Ajo do të ndihmojë që në Tokë të mbisundojë e mira, ndërsa e keqja gjithsesi të zvogëlohet. Tekstet e dhëna tregojnë cilat janë kontributet e njerëzve nga mbarë bota.

## **PËRGJEGJËSI PËR GJITHÇKA QË JETON**

Filozofi, teologu, muzikanti dhe etiku i njohur **Albert Shvajcer** (1875-1965), fitues i çmimit Nobel për paqe (1952), i cili ndërtoi spital në Afrikë, ka shkruar se njerëzit duhet të mësojnë nga gjithë njerëzit e mirë dhe të mençur nga mbarë bota:

„Mua, para së gjithash, më mundon pyetja çka mundem si njeri të bëj për njerëzimin... E vërteta, dashuria, dashamirësia, durimi dhe mirësia janë forca të cilat do t'i mundin të gjitha forcat tjera dhe çdo dhunë... Vetëm nëse njerëzimi pretendon drejt qëllimeve etike, mundet në tërësi t'i shfrytëzojë të mirat e përparimeve materiale dhe të udhëheq me rreziqet që e përcjellin atë progres”.

## VLERAT UNIVERSALE ETIKE

“Etika është orientuar të veprojë midis ngjarjesh të vërteta dhe të përmirësojë sjelljen e botës reale... Etika është përgjegjësi e paskajshme ndaj gjithçka që jeton... Etika fillon aty ku mbaron të folurit”.

Shvajcer iu ka bërë nder të madh njerëzve që kanë bërë vepra të mira: „Shumë nga gjërat që unë nuk do t'i ndjeja me aq qartësi dhe kurrë nuk do t'i bëja, i kam bërë dhe i kam ndjerë, sepse isha nën ndikimin e njerëzve të mirë. Shumë nga vijat tona të karakterit: butësinë, mirësinë, thjeshtësinë, gatishmërinë për të falur, ndershmërinë dhe vetëpërmbajtjen, ne ua kemi borxh njerëzve të cilët me vepra na i kanë treguar ato vepra të mira... Mendimi që shndërrohet në vepër, tek ne hyn si një shkëndijë dhe ndez një zjarr të ri.”



### PYETJE PËR PËRSËRITJE

A vlen morali për vetë njeriun, ose vetëm për grupin, apo ka vlerë në tërë botën?

Pse vlerat dhe normat morale mbeten të njëjta në mbarë botën?

Çfarë vlere është ndershmëria? A është e nevojshme për njerëzit?

Në cilat sfera të jetës dhe në cilat çështje është e rëndësishme ndershmëria?

Çka do të thotë fer-plej në lojë?

A mund të kuptohet e vërteta pa dashamirësi?

Cili kolos bashkëkohor indian e ka theksuar shumë nevojën për të vërtetën?

Çka është gënjeshtër?

A është më mirë të thuhet e vërteta apo gënjeshtër?

Drejtësia, a është normë e etikës e cila mbrohet edhe me të drejtën? A duhet të gjithë qytetarët të jenë të barabartë para drejtësisë?

A është drejtësia e nevojshme për njerëzit? Nëse nuk është i drejtë, çfarë është ai njeri, nëse nuk ka drejtësi, çfarë është ai mjedis?

Patriotizmi, a është ndjenjë e rëndësishme sot? Si përhapet në mbarë botën?

Cila është porosia e Presidenti Xhon Kenedi për patriotizmin?

Cilat janë sferat më të rëndësishme të etikës së sotshme?

Si quhet shkenca e re për kujdesin dhe mbrojtjen e shëndetit dhe natyrës? Nga cilat dy shkenca përmban emra në emrin e vet?

A duhet të ruhet shëndeti? Si ruhet shëndeti?

A duhet të kujdesemi për natyrën? Si quhet shkenca e cila shpjegon kushtet për jetesë të njeriut në ambientin e tij jetësor? Si quhet etika e cila mëson si duhet ta ruajmë natyrën dhe ambientin jetësor?

Etika ekologjike, a do të thotë edhe kujdes për kushtet e natyrës (trualli, uji, ajri, xehet...), për bimët dhe për kafshët?

Kur punoni me kompjuter, a keni kujdes nga njerëzit e këqij që mund t'ju bëjnë keq?

Si quhet etika bashkëkohore e cila është e përgjithshme për të gjithë? Nga cilat elemente ndërtohet ajo?

Cilat janë vlerat themelore të etikës së përgjithshme të të gjithë njerëzve sot?

Cilat mësimet nga etikët tanë mendojmë se do të hynin në etikën e përgjithshme të njerëzimit?



Në pjesën e tretë të librit bëhet fjalë për **SJELLJEN E MIRË** të njerëzve. Çdo burrë/grua ka jetë dhe dukje personale. Secili/secila për vete është UNI, qenie e përveçme, dhe njihet sipas veprimeve, diturive, besimeve, ëndrrave, shprehive jetësore dhe karakteristikave. Të gjithë e njohin ashtu atë person, e në të njëjtën mënyrë edhe ai e një vetveten. **Uni** është shenja më e fortë e ekzistimit personal. Etika na mëson se duhet të kemi kujdes në UNIN tonë, por edhe se duhet të kemi kujdes në sjelljen ndaj tjerëve. Në atë dinjitet të përbashkët të të gjithë personave, ne respektin dhe kujdesin e ndërsjellët fshihet fitorja më e madhe e mendjes dhe moralit njerëzor – të ngrihet më lart si person i mirë, por edhe ta kufizojë veten dhe forcat negative për t'i arritur vlerat pozitive.

Ana tjetër e ekzistimit njerëzor është TJETRI. Çdo njeri ka të afërmit e vet, familje, shokë dhe bashkëpunëtorë, ndërsa për të, të gjithë janë të afërmit e tij, njeriu i një të afërmit, me ta e lidhin kontaktet, me ta ka lidhje më të gjatë apo më të shkurtër, ngjarje të përbashkëta, ata i besojnë njëri tjetrit. Gëzohen gjatë takimeve me të afërmit, i ndajnë brengat dhe gëzimet.

*Personi i afërt*, është ai që ndodhet pranë njeriut, që është fqinji i tij/saj, por nuk e njeh dhe ende nuk është afruar me të. Ka aq shumë njerëz në botë dhe të gjithë ata janë pjesë e jetës sonë. Të afërmit janë njerëz të cilët kanë plane dhe vepra të tyre, shpresa dhe dëshira, shpirt dhe zemër, mendime dhe jetë të veten, gëzime dhe vuajtje. Njeriu nuk është vetë në botë. Afër tij /saj jetojnë shumë të tjerë - edhe pse nuk kanë raporte me ta, sërish është i vetëdijshëm/vetëdijshme se ata ekzistojnë. Në botë ka natyrë dhe bukuri, shtazë dhe bimë, dhe shumë vepra njerëzore, por sërish pjesë më e rëndësishme në botë është njeriu. Të afërmit janë të gjithë njerëzit në botë, si nga ana jonë ashtu edhe nga ana tjetër e Tokës, edhe nga lloji im edhe nga raca tjetër. Të gjithë ne e përbëjmë njerëzimin. **Për njerëzit e mirë i afërt është çdo njeri.** Çdo i afërm nesër mund të më bëhet i afërt.

Prandaj qëllimet e mija morale kanë të bëjnë jo vetëm për të afërmit e mi, por për të gjithë njerëzit. Me rëndësi është mirë të sillem në çdo fushë të jetës dhe mirë të veprojmë ndaj të gjithëve me të cilët takohemi.

## SJELLJE E MIRË

Të gjithë njerëzit janë të afërm dhe mund të bëhen të afërt kur të njoftohen dhe të bashkëpunojnë. Çdokush duhet të respektojë të gjithë njerëzit - nga rrethi i ngushtë, nga krahina e tij, nga regjioni më i gjerë dhe mbarë bota, sepse të gjithë njerëzit janë të barabartë dhe më së miri është të jenë shokë mes veti.

Etika mëson për vlerat e mira të raporteve mes njerëzve. Vlerat e tilla janë: Paqe - të mos ketë konflikt dhe luftë mes njerëzve; Dashuri - ndjenja të pastra dhe respekt; Vullnet i mirë -dëshirë që të sillem mirë dhe t'i dua të gjithë njerëzit; Miqësi - ndjenja të mira, të ndërsjella dhe shoqërim.

Një grup i vlerave të këtyra janë bazë e jetës së përbashkët dhe ato duhet t'i ndjekë çdo njeri: Kujdes, Ndhimë, Mirëkuptim, si dhe Tolerancë dhe Bashkëpunim.

KUJDESI është interesim për gjendjen e dikujt ose diçka tjetër, dëshirë për të qenë mirë. Atë e ndjek edhe sjellja e mirë njerëzore. Ajo dëshmon për ndjenjën tonë të sinqertë ndaj njerëzve të tjerë ose ndaj ndonjë pune. Ne, mendimet dhe veprat ua përkushtojmë ndonjë gjendjeje ose njeriu, që të përmirësohen dhe të ndjehen mirë, e me këtë edhe ne të ndjehemi mirë. Është mirë nëse detyrat tona i kryejmë me kujdes, vëmendje, interesim dhe përkushtim.

NDIHMË do të thotë t'i japim dikujt diçka, si përkrahje dhe kontribut për jetën ose punën e tij. Ndhimja jep mbështetje dhe ua lehtëson detyrat dhe vështirësitë, mundëson harmoni mes njerëzve në qëllimet e mira dhe bashkëpunim në veprim. Prandaj ndihma vlerësohet si vepër e bekuar, e cila është e nevojshme për njerëzit, dhe çdo njeri duhet të bëjë të njëjtën.

MIRËKUPTIM është mendim dhe sjellje e urtë. Për jetën e përbashkët të njerëzve kjo do të thotë kuptim i mirë i jetës nga të dyja palët, si dhe i qëllimeve dhe veprimeve të të tjerëve, pajtueshmëri e shumicës rreth jetës së përbashkët. Me mirëkuptim arrihet marrëveshje dhe besim, pajtueshmëri dhe bashkëpunim i ndërsjellë. I kuptueshëm e quajmë atë i cili mendon mirë dhe i ndjek rregullat morale.

### **HELP EVER, HURT NEVER**

(nga gjuha angleze - Çdoherë ndihmo, asnjëherë askënd mos lëndo!) është porosia më e njohur bashkëkohore e etikës.

Këto vlera dhe sjellje morale janë të rëndësishme. Ato mundësojnë njerëzit të pajtohen dhe të sillen mirë. Prej tyre buron DËSHIRA PËR SJELLJE ETIKE, e cila është bazë për moralin dhe paraqet respekt të rëndësishëm së moralit për jetën njerëzore, në fakt përpjekje e njeriut të veprojë mirë, drejt, me drejtësi, me nder.

Qëllimet dhe sjelljet e kundërta - si jo toleranca, moskujdesi, mos ndihma, mosbashkëpunimi, moskuptimi - nënkuptojnë braktisjen e etikës dhe pranimit të dhunës, të keqes, armiqësisë. Njerëzit nuk duan ata të cilët nuk i respektojnë vlerat themelore të jetës së përbashkët; personat e atillë negativ duhet të ndryshojnë sjelljet e tyre për të qenë pjesëtarë të mjedisit jetësorë.

### **TOLERANCË -**

durim, kuptimi që njerëzit e tjerë janë të ndryshëm nga ne dhe mos kundërshtimi mes dallimeve, durim i ekzistimit të huaj, mendim, besim ose vështrim; toleranca këshillon të mos përdoret dhunë dhe shtypje gjatë grindjeve si dhe gjatë shprehjes së qëndrimeve personale. Indianët kanë qëndrim të mirë për tolerancën, e quajnë *ahimsa* - jo dhunë, mos bërje keq as në mendime, as me fjalë, as me vepra; dhe kjo nuk është e kufizuar vetëm ndaj njerëzve, por bëhet fjalë edhe ndaj kafshëve edhe ndaj bimëve. Ana e kundërt, e keqe e saj është jo toleranca, kur nuk mund të duroj askënd, vetëm zihem, mendoj që vetëm qëndrimi im është i drejtë dhe drejtohem kundër gjithkujt; kjo është e lidhur me dhunën, agresivitetin, mendime të këqija, me krimin.

### **BASHKËPUNIM -**

kryerja e përbashkët e punës, ndihmë gjatë punës, posaçërisht nga kolegu, me të cilin ndahen detyrat, orari i punës dhe aparatet; me ndarjen e punës ajo kryhet më lehtë dhe fitohet rezultat më i mirë - bashkëpunimi mundëson mbështetje ndaj kolegut në punë dhe në jetë, gjë e cila është e mirë për njerëzit.

Edhe pse etika vazhdimisht bën fjalë për **Të mirën** dhe **Të keqen**, nuk është e mjaftueshme vetëm ta duam të mirën ose të flasin keq për të keqen. **E mira duhet edhe të bëhet, ndërsa e keqja fare të mos bëhet.** Nëpërmjet zgjedhjes të së mirës dhe vepërimit të drejtë përkatës maten qëllimet dhe sjelljet e njerëzve. Ajo quhet SJELLJE E MIRË.

Njerëzit e mësojnë moralin me mësim dhe me dëgjim të këshillave, me mësim të etikës dhe me ngritje kulturore,

**NOCIONET  
KRYESORE  
ETIKE**

## SJELLJE E MIRË

ndërsa me rëndësi është edhe dëshira e tyre dhe përpjekja që të jenë të mirë dhe më të mirë. Njerëzit e mirë kanë kujdes se çka bëjnë dhe shohin të veprojnë me moral. Prandaj ata nuk presin lëvdata të posaçme (edhe pse mendojnë në atë se nuk duhen të jenë të kritikuar për sjellje të keqe). Njerëzit ndjejnë dhe dinë që sjellja e mirë është me rëndësi. Qëllimet e këqija dhe sjellja jo e mirë çdoherë shkakton të keqe për ndonjë njeri ose për ndonjë genie tjetër. Ndërsa ajo njëherësh paraqet edhe të keqe për vet-veten.

Për qëllimet dhe sjelljet e këqija njeriu ballafaqohet me faj dhe vlerësohet negativisht. Sjelljen e mirë, para së gjithash, të gjithë e pëlqejnë dhe e vlerësohet pozitivisht. Ashtu është në të gjitha anët e botës - edhe tek sjelljet në familje, edhe në aktivitetet ndaj natyrës, bimëve dhe shtazëve, në punë (për të rinjtë mësimi është punë), edhe ndaj njerëzve tjerë, edhe ndaj shokëve, edhe ndaj pronës dhe sendeve...

Për rëndësinë e sjelljes së mirë flasin edhe notat të cilat njerëzit i kanë. Për sjelljen e mirë thonë se është morale, etike, e mirë, e bukur, në rregull, e drejtë, e vlefshme, e dobishme, e vlerësuar, e dashur, e shkëlqyer. Për sjelljen e keqe thonë se është jomorale, joetike, e keqe, e shëmtuar, e parregullt, e padrejtë, pavlerë, e pashfrytëzuar, e padashur, jo e bukur.

Duhet të dihet – kur shumica të tërheqin vërejtjen për sjelljen, duhet të mendosh, ka diçka që nuk është në rregull. Ndrysho sjelljet!

### MOS FOL SE DUHET TË VEPROHET MIRË, POR VEPRO ASHTU!

*Mbreti romak - etiku Marko Aurelij*



#### ËSHTË NË RREGULL

- + Të jemi të ndershëm!
- + Të jemi të ndershëm!
- + Të kemi kujdes në sjelljen personale!  
Të lavdërohen ata që veprojnë mirë!
- + Të jemi tolerant, të çmosh të gjithë njerëzit!
- + Të duhen të gjithë njerëzit!



#### NUK ËSHTË NË RREGULL

- Të jemi të pandershëm!
- Të mos kemi kujdes në sjelljen personale!
- Të lavdërohen ata që bëjnë keq!
- Të qenit jotolerant, të mos çmohen njerëzit
- Të mos duhen njerëzit!



Krahaso çiftet vlerash në vazhdim, mendo dhe caktto cila vlerë është e mirë, e cila e keqe; cilën do të dëshiroje ti ta ndjekin njerëzit, dhe gjithashtu e ndjek edhe ti - si dhe pse e kundërta është e keqe dhe çka u shkaktohet njerëzve me to?

Ndershmëri	Pandershmëri
Xhentilitet	Jo xhentilitet
Edukatë	Jo edukatë
I njerëzishëm	I panjerëzishëm
Humanitet	Jo humanitet
Moral	Amoral
Dashuri	Urrejtje
Pastërri	Papastërri
Kujdes	Pakujdesi
Dashuri për punë	Përtaci
Drejtësi	Padrejtësi

## DITA E KËRKIMIT TË FALJEVE

Popullata e krishterë ka një festë etike, me të cilën shënohet rëndësia morale e kërkimit të faljes mes njerëzve. Në atë ditë përkujtohem në bukurinë e raporteve të mira mes nesh, përkundër sjelljeve të mundshme të këqija dhe reagimeve të shëmtuara midis njerëzve. Si unë, ashtu edhe të tjerët, mund të gabojmë, por të falim është më njerëzore dhe më mirë, të jetojmë në gëzim dhe harmoni dhe të mos i bëjmë të këqija njëri-tjetrit. Ajo ditë quhet "PROÇKA", Dita e kërkimit të faljeve. Atëherë mendojmë në gjërat e bukura të jetës, dhe prej tyre më të mira janë ndërgjegjja e qetë, gëzimi, raportet e mira mes njerëzve dhe respekti. Për këtë para se gjithash duhet të jemi tolerant, të mos hidhërohemi, të mos na kaplojë mllëfi, i cili mund të jetë shumë keq kur shpërthen fuqishëm ose kur zgjat shumë. Shumë njerëz të mençur dhe etik tregojnë se falja është qasja më e mirë njerëzor dhe veprim që e lehtëson jetën.

Të falurit nuk do të thotë së pari të kërkojmë nga të tjerët të sillen mirë ndaj nesh; para se gjithash ne duhet të bëjmë një hap para, të sillemi mirë me të tjerët. Në Ditën e kërkimit të faljes ne u kërkojmë falje njerëzve që u kemi bërë gjëra jo të mira, duke kërkuar të na falin, sikur që edhe ne ua falim atyre të cilët kërkojnë mirëkuptim dhe falje. Gjithashtu, duhet të mundohemi të pastrojmë zemrën nga mendime të papastrat për hakmarrje ose për armiqësi dhe t'i parashtrijmë detyrë vetes të jetojmë me mirëkuptim dhe kujdes për të tjerët dhe të sillemi mirë.

Por, nuk duhet të presim Ditën e caktuar të kërkimit të faljeve për gjestin e bukur të faljes me të afërmit. Atë mundet dhe duhet ta bëjmë çdo herë kur mendojmë se kemi gabuar ndaj dikujt. Duhet të jemi të vetëdijsëm se nuk duhet të kemi mendime të këqija dhe se duhet të kemi kujdes të mos lëndojmë të afërmit. Gjithashtu, duhet të mundohemi të harrojmë dhe të tejkalojmë nëse na është bërë diçka e keqe. Më e rëndësishme është të kuptojmë se jetojmë me njerëzit dhe vite të shumta do të kalojmë së bashku dhe duhet të pajtohemi mes veti. Mospajtimet janë forma më e rëndë për jetesë.

Bisedoni për përvojat tuaja me gabimet dhe ofendimet ndaj njerëzve dhe si jeni sjellë, a keni kërkuar falje.

**DUKE FALUR,  
NJERIU NGRIHET MBI ATA QË E OFENDOJNË.**

*Napoleoni*

Diskutoni me shokët tuaj sa është falja e mirë, dhe sa hidhërimi është i keq për raportet mes njerëzve.

**NË FAMILJE TË GJITHË DUHET TË DUHEN, TË RESPEKTOHEN DHE TË NDIHMOHEN**



Familja është bashkësia më e ngushtë e njerëzve. Në familje njerëzit janë më të afërt, aty janë të lidhur prindërit dhe fëmijët, ndërsa rreth tyre janë familjarët dhe shokët. Njeriu jeton në familje, aty organizon vendbanimin dhe fitimin, mban evidencë për ushqimin, higjienën dhe shëndetin, e planifikon të ardhmen, ndërsa me anëtarët tjerë së bashku blen dhe përdor sende. Familja është lidhje e atyre që jetojnë së bashku dhe përkrahen në jetë, lidhshmëri për ata që duhen dhe kanë qëllime të

njëjta në jetë.

Detyrat në familje me dëshirë pranohen dhe kryhen. Atëherë në familje mbretëron Dashuria dhe Besimi, si forca elementare familjare dhe vlera morale.

Si bashkësi e parë biologjike dhe sociale, familja është bazë për të gjitha lidhjet e tjera shoqërore të njerëzve. Nga shtëpia të gjithë nisen për në shkollë dhe në punë. Në familje çdokush për herë të parë takohet me etikën dhe ndërtohet si person i moralshëm. Familja është bazë për shëndetin e njeriut, edukimin, vetënjohjen, ngritje personale... Në familje njerëzit e ndajnë të mirën dhe të keqen, së bashku përparojnë ose humbin, së bashku gëzohen ose vuajnë. Gjithçka me rëndësi që u ndodh ka pasojë ndaj gjithë anëtarëve të familjes. Prandaj anëtarët e familjes duhet të jenë kompakt, që të munden mirë të luftojnë dhe të përparojnë. Shkalla më e lartë është dashuria në familje, e cila i çon dhe i shtyn anëtarët e saj në sjellje të mira, që pjesëtarët e familjes dhe të afërmit e tjerë të dashur të ndjehen mirë.

besim	mosbesim
shoqëri	armiqësi
mirëkuptim	moskuptim
luftë e përbashkët	veprim i veçuar
dashuri	jo dashuri
ndihmë	jo ndihmë
interesim	mosinteresim
	(njëri ndaj tjetrit)
besnikëri	jo besnikëri
kujdes	moskujdes



Shikoni këto çifte vlerash dhe kundërvlerash dhe vlerësoni për cilën nga këto mendoni se është më e rëndësishme për fatin apo fatkeqësi në raportet familjare.

Krahasoni përgjigjet me ato të shokëve tuaj dhe komentoni zgjedhjet e juaja dhe të tyre me rëndësinë për jetën e përbashkët (familjare) të njerëzve.

### ✓ NË FAMILJE DUHET

- + Të duhen dhe të respektohen!
- + Të kryhen detyrat!
- + Të ndihmohet (sepse ajo mundëson jetë më të mirë)!

### ✗ NË FAMILJE NUK DUHET

- Të mos respektohen të afërmit tanë!
- Të largohemi dhe të mos kryejmë detyrat tona!
- Të mos ndihmohet (sepse ajo pamundëson jetesë të mirë)!

## FAMILJA ËSHTË ATDHEU I ZEMRËS

*Xhovani Mancini*

Rregullat themelore të sjelljes në shoqëri vlejnë edhe në çdo familje dhe për çdo njeri, përndryshe ata do të konsideroheshin si të pavetëdijshëm ose të pamoralshëm dhe njerëzit do t'i kritikonin dhe do t'u shmangeshin. Për shembull, nga të gjithë njerëzit pritet ta mirëmbajnë mjedisin jetësor, të sillen në mënyrë të përshtatshme dhe pa shumë zhurmë, të mos jenë të dhunshëm dhe të mos lëndojnë të tjerët, të mos marrin dhe të shkatërrojnë sendet e të tjerëve ose të mirat e përgjithshme, t'i duan fëmijët, t'i respektojnë të tjerët në rrethin e tyre (ndërtesë, lagje, fshat, qytet, rrethinë dhe shtet). Këto janë, kryesisht, norma të përgjithshme njerëzore për paqe, solidaritet, bashkëpunim dhe respekt ndaj të gjithë njerëzve.

Megjithatë edhe çdo familje ka moral të vet, norma specifike të sjelljes, të cilat janë të lidhura me qëllimet dhe vlerat e anëtarëve të familjes. Në ndonjë familje më shumë mbahet llogari për arsimin dhe kulturën dhe nga të gjithë kërkohet të mësojnë me seriozitet. Në të shumtën e familjeve të gjithë i përkushtohen punës dhe fitimit,

## SJELLJE E MIRË

kështu që edhe nga më të vegjlit pritet të japin kontribut. Diku kursehet me të madhe dhe vazhdimisht jepen këshilla për ruajtjen e gjërave dhe mos hedhjen. Në disa familje anëtarët janë më të tërhequr dhe shoqërohen kryesisht vetëm mes vete, ndërsa në familje të tjera kanë numër të madh shokësh dhe vazhdimisht kanë dikë për vizitë ose ata shkojnë diku në vizitë. Diku ushqehen begatshëm, madje edhe tej mase, ndërsa diku janë vegjetarianë, ushqehen vetëm me perime dhe pemë. Morali familjar është një gjë me rëndësi, çdo i ri mësohet për sjellje në familjen e tij, ndërsa sjelljet elementare të cilat mësohen në fëmijëri mbeten të rrënjësura në karakterin dhe sjelljen e personit. Megjithatë, edhe përkundër dallimeve familjare, që e përbëjnë pasurinë e etikës së njerëzimit, duhet gjithsesi të ndiqen normat kryesore etike të shoqërisë dhe normat e përgjithshme njerëzore.

Në familje veçanërisht pritet të respektohen normat morale të respektit reciprok dhe të dashurisë së anëtarëve të saj.

Prindërit duhet të kenë kujdes ndaj fëmijëve dhe t'u sigurojnë ushqim dhe pastërti, t'i nxisin në higjienë, t'i mësojnë në normat elementare të sjelljes së mirë, t'u mundësojnë lojë dhe sport, t'i orientojnë drejt kulturës dhe t'i përgatisin për mësim. Kur të rinjtë do të shkojnë në shkollë, prindërit duhet t'i ndjekin rezultatet e tyre dhe t'u ndihmojnë nëse ka nevojë. Ata duhet t'u tregojnë fëmijëve edhe për problemet që kanë, që fëmijët të dinë se me çfarë problemesh ballafaqohet familja (nuk ka familje që nuk ka vështirësi - me shëndet, organizimin, të hollat...).

Fëmijët duhen të jenë të vetëdijshëm se janë anëtarë të familjes. Ata duhet t'i respektojnë prindërit, si dhe prindërit e tyre dhe farefisën më të vjetër (nëse janë gjallë), sepse ata i kanë lindur dhe kujdesen për jetën e tyre dhe sukseset. Edhe nga të rinjtë pritet t'i kryejnë obligimet e tyre, sepse çdo njeri ka detyra. Fëmijët duhet ta mirëmbajnë higjienën personale dhe të shtëpisë, të dëgjojnë prindërit dhe më të vjetrit për punët kryesore, të mos i prishin sendet në amvisëri, t'i ruajnë veshmbathjet, shtratin dhe dhomën, të mësojnë dhe të mos u bëjnë keq të tjerëve. Në fakt, të rinjtë duhet pasur kujdes çka bëjnë, ta bëjnë mirë atë që duhet ta bëjnë dhe të sillen me dashurin ndaj familjes.



Sjellja e mirë në familje do të thotë kryerje me kohë dhe me rregull të detyrave familjare, të cilat i kanë dhe duhet t'i bëjnë të gjithë anëtarët e familjes në mënyrë të barabartë sipas moshës dhe fuqisë, por me interesim të barabartë dhe përkushtim reciprok. Në familje të gjithë duhet të jenë shokë dhe të bashkëpunojnë - këto janë parimet elementare të etikës dhe të sjelljes së mirë në familje.

## **NË FAMILJE**

### **ËSHTË MIRË NËSE FËMIJA:**

- zgjohet herët dhe në kohë shkon në shkollë,
- pastrohet dhe rregullisht lahet,
- rrobat i ruan mirë,
- dëgjon prindërit dhe më të vjetrit,
- nuk gënjen më të vjetrit,
- nuk merr të holla pa pyetur dhe pa leje dhe nuk i harxhon pa mend,
- shkon mirë me vëllezërit dhe motrat,
- ndihmon në shtëpi dhe kryen detyrat,
- ka mirëkuptim për problemet e vështira në familje,
- ruan pronën dhe kujdeset të mos prishen sendet,
- mëson mirë dhe përparon,
- të gjithë janë të kënaqur nga ai/ajo.

### **ËSHTË KEQ NËSE FËMIJA:**

- nuk zgjohet herët dhe nuk shkon me kohë në shkollë,
- nuk pastrohet dhe nuk lahet me rregull,
- gris veshmbathjet, i mban në mënyrë të parregullt, i hedh dhe i humb,
- nuk dëgjon prindërit dhe familjarët më të vjetër,
- gënjen më të vjetrit,
- merr të holla pa pyetur dhe pa leje dhe i harxhon pa mend,
- nuk shkon mirë, grindet me vëllezërit dhe motrat,
- nuk ndihmon në shtëpi dhe refuzon punën,
- nuk ka mirëkuptim për problemet në shtëpi,
- nuk e ruan pronën dhe i prish sendet,
- nuk mëson mirë dhe nuk përparon,
- askush nuk është i kënaqur nga ai/ajo.

## **MËSO VYESHËM, NDËRSA NË SHKOLLË BËHU SHOK ME TË GJITHË!**

Shkolla është një ndër veprimtaritë më të dobishme që ka zbuluar njerëzimi. Çdo fëmijë duhet të rritet, të mësojë shumë gjëra për jetën, të arsimohet dhe të pajiset me njohuri të ndryshme, të formohet si person. Nga lindja e deri në pjekuri për atë duhen të kenë kujdes të gjithë, edhe prindërit edhe tërë mjedisi. Më parë, kur ka pasur më pak gjëra për të mësuar, të gjithë kanë mësuar nga personi më i aftë në grup, në shtëpi ose në bashkësi. Por, që moti njohuritë janë zgjeruar shumë, dhe janë krijuar shkolla, ku fëmijët i mësojnë të gjitha gjërat e nevojshme. Ajo sot është

## SJELLJE E MIRË

aq shumë e përhapur, saqë të gjithë fëmijët në botë, që në moshën pesë-gjashtë vjeçe nisen për në shkollë dhe shkollohen më së paku dhjetë vjet, ndërsa më shpesh edhe nga 15 ose 20 vjet, derisa nuk bëhen profesionistë (mandej mësojnë pa ndërprerje dhe gjatë tërë jetës).

Prandaj shkollat janë bashkësi të mëdha. Në to ka edhe nga 1 000 - 2 000 fëmijë, ndërsa janë të përfshira të gjitha gjeneratat nga ajo lagje apo regjion. Shkolla është shtëpi e dytë për fëmijët, sepse në të kalojnë pjesën më të madhe të ditës, gati tërë javën dhe shumë muaj në vit (përveç kur është pushimi). Atje shoqërohen me moshatarët, së bashku zhvillohen, mbeten shokë dhe i mësojnë dituritë më të rëndësishme dhe shkathtësitë të cilat do t'u nevojiten në jetë dhe në punë. Njëra nga ato gjërat me rëndësi është të mësuarit e Etikës, si shkencë për të mirën, për vlerat morale të cilat çdo njeri duhet t'i çmojë dhe kryejë.

Pasi që të mësuarit është me rëndësi për fëmijët, nga fëmijët gjithsesi pritet sjellje e mirë në shkollë. Disa sjellje të mira janë të lidhura me mësimin, të tjera me sjelljen e duhur në shkollë, ndërsa të tretët me relacionin me nxënësit e tjerë.



Shkolla është vend ku fëmija rritet, ku ka gjasa të zhvillohet drejtë dhe të mësojë sende të mira e të ndryshme. Prandaj çdo fëmijë duhet të mundohet të mësojë mirë, me rëndësi është të shfrytëzojë rastin për të mësuar. Shteti paguan që të organizohet mësimi, angazhon mësues dhe shërbime të tjera që mësimi të jetë i suksesshëm, ndërsa shpenzime të mëdha kanë edhe

prindërit. Detyrë e çdo fëmije është të arsimohet, të mundohet aq sa nga ai/ajo pritet të mësojë (ndërsa ajo nuk është e tepërt dhe mund ta bëjë secili fëmijë). Ajo fëmijëve do t'u ndihmojë të jetojnë më mirë dhe të gjinden në jetë.

Duhet të thuhet se edhe me cilësi mesatare mund të arrihet sukses nëse punohet vyeshëm, atëherë sukcesi do të jetë më i madh edhe nga ata fëmijë të cilët kanë talent, ndërsa nuk mundohen dhe nuk punojnë sa duhet. Shkolla është si vend pune për fëmijët, ndërsa më shumë arrijnë ata të cilët janë të interesuar, më mirë dëgjojnë dhe përpiqen më shumë.

Gjithashtu për çdo fëmijë është me rëndësi të jetë shok me të gjithë fëmijët, ndaj më të rriturve të ketë respekt, ndaj fëmijëve të gjeneratës së vet të jetë i hapur dhe i prirë për shoqëri, ndërsa ndaj më të vegjëlve të tregojë kujdes. Ndërmjet fëmijëve është me rëndësi të ketë durim e jo refuzim. Për shembull, paramendoni, nëse disa janë më të pasur, pse t'ua keni lakminë, edhe ju me mësim do të bëheni të aftë që të fitoni dhe do të keni. Nëse disa fëmijë janë më të varfër, mos i refuzoni, mos u sillni keq ndaj tyre, ata janë qenie njerëzore dhe kanë nevojë për fjalë të mira dhe përkrahje, ndoshta edhe mund t'ju gjinden kur ju do të keni nevojë. Me shokët e gjinisë tjetër duhet të silleni mirë dhe përshtatshëm, që të jetoni mirë së bashku, ndërsa me ata të së njëjtës gjini ushtroni dhe bëhuni të lidhur që të ndihmoheni tash por edhe në të ardhmen.

Sot kur të gjithë fëmijët shkollohen, shkollat u ngjajnë ndërmarrjeve të mëdha. Në to ka shumë dallime: çdo fëmijë ka qëllime të veta dhe ambicie, dhe çdo kush ka karakter të ndryshëm. Ajo është vështirë të harmonizohet, por të gjithë duhet të jetojmë dhe të rritemi së bashku dhe gjatë viteve të mësojmë çka është e nevojshme dhe të jemi të gatshëm për fillime të suksesshme në jetë. Prandaj, në shkollë vendosim në lidhje shoqëri, të cilat vazhdojnë gjatë tërë jetës, ndërsa shokët shpesh janë aq të afërt, sa që fillojnë të llogariten si vëllezër dhe motra.

Kjo, fëmijë, do të thotë se duhet të silleni në mënyrë përkatëse me moshën dhe shkollën. Ta ruani shkollën dhe pronën, të respektoni mësuesit! Të mësoni dhe të respektoni diturinë që është arritur në mbarë botën, ndërsa njerëzit duan ta ndajnë me ju dhe t'ju përcjellin që ta shfrytëzoni! Gjithashtu, nuk duhet t'ju pengojmë, por t'ju ndihmojmë të tjerëve. Të gjithë fëmijët në shkollë kanë qëllim të përbashkët - të rriten dhe të bëhen persona të pjekur, të cilët do të mund të punojnë mirë dhe të sillen mirë.

## NOCIONET KRYESORE ETIKE

### **PËRGJEGJËSI -**

është gjendje dhe kuptim i personalitetit në aspekt të vetëdijes personale (dhe të përgjithshme) për detyrat dhe pozitën personale si bartës i veprimtarive: **përgjegjësi morale** - vetëdija e njeriut për veprat dhe sjelljet e veta.

## NË SHKOLLË

### ËSHTË MIRË NËSE FËMIJA:

- arrin në kohë,
- përgatitet për orët,
- koncentrohet që të mësojë me sukses,
- është i qetë dhe dëgjon mësimet,
- i kryen detyrat,
- mban higjienën dhe rendin në klasë,
- i respekton mësuesit dhe shokët,
- i ruan me kujdes librat dhe veglat,
- mundohet të arrijë sukses,
- nuk sjell ngatërresa dhe nuk grindet me fëmijët e tjerë, bën sport, merr pjesë në të gjitha aktivitetet që e interesojnë, si dhe në ato të shokëve të vet, që ashtu të mësojë më shumë,
- kujdeset për vegëlirinë shkollore dhe nuk e dëmton,
- nuk merr asgjë pa pyetur,
- nuk ua ka lakminë të tjerëve, por shoqërohet,
- u ndihmon të vegjëlve, më të dobëtëve, më të varfërve,
- flet siç i ka hije, nuk thotë fjalë të këqija dhe nuk fyen,
- nuk fillon të pijë duhan,
- të gjithë janë të kënaqur nga ai/ajo.

### ËSHTË KEQ NËSE FËMIJA:

- nuk arrin në kohë,
- nuk përgatitet për orët,
- nuk koncentrohet të mësojë,
- nuk është i qetë, nuk dëgjon mësimet dhe u pengon të tjerëve,
- nuk i kryen detyrat,
- nuk e mirëmban higjienën dhe rendin në klasë,
- nuk respekton mësuesit dhe shokët,
- nuk i ruan me kujdes librat dhe veglat,
- nuk mundohet të arrijë sukses,
- bën probleme dhe grindet me fëmijët e tjerë,
- nuk bën sport,
- nuk merr pjesë në aktivitete të ndryshme (duke thënë që nuk i interesojnë) si dhe në ato të shokëve të vet, largohet dhe i përqesh,
- nuk kujdeset për veglat shkollore dhe i dëmton,
- merr sende pa pyetur dhe vjedh të holla,
- ua ka zilinë të tjerëve, nuk shoqërohet me fëmijë të tjerë,
- nuk u ndihmon më të vegjëlve, më të dobëtëve, më të varfërve, dhëm i maltreton, flet ashtu siç nuk i ka hije, thotë fjalë të pakëndshme dhe fyen,
- fillon të pijë duhan,
- askush nuk është i kënaqur nga ai/ajo.

### FJALORI ETIK



**Kodeks shkollor** - rregulla të sjelljes në shkollë, në klasë dhe ndërmjet nxënësve dhe mësuesve

**Kolegjialitet** - norma etike të sjelljes ndërmjet mësuesve (kolegë profesorësh) dhe ndërmjet nxënësve (kolegë nxënësish), si respekt reciprok dhe bashkëpunim të të njëjtëve në procesin e punës.

## SECILI DUHET TË KETË KUJDES SI SILLET NË PUBLIK

Njeriu ka dy lloje të jetesës, mendim dhe sjellje – personale dhe publike. Në fakt, nuk duhet pasur dallim mes asaj që është në shpirtin e njeriut dhe normat morale dhe sjelljet e tij. Ka njerëz tek të cilët ka dallim si mendojnë në vete dhe si sillen publikisht dhe ndaj njerëzve të tjerë - ata i quajmë me një emër fyes *homo duplex* (qenie me veti të dyfishtë, veti dhe sjellje të ndryshme ose siç thuhet tek ne „Mendon dhe flet njëjërën, ndërsa vepron tjetër, ndryshe”). Gjithsesi, personat serioz dhe të mirë mendojnë mirë dhe veprojnë mirë, dhe nëse diçka nuk iu pëlqen, ata u thonë të tjerëve se nuk pajtohen dhe i kritikojnë, nuk i fshehin në vete njohuritë, ndjenjat dhe vlerat morale, nuk veprojnë asgjë pas shpinës së dikujt.

Kjo tregon se sa është e rëndësishme sjellja publike. Publike, domethënë ajo që shihet, **që bëhet para syve të dikujt**, jo ajo që e mbaj në vete ose e bëj vetëm në rrethin më të ngushtë të të afërmeve, në shtëpi, në familjen më të ngushtë. Publike është ajo që ka të bëjë me më shumë njerëz dhe për ç’gjë, shumë njerëz munden të japin gjykimin e vet. Publike është çdo e folur ose veprim, përveç asaj që është e mbyllur në mendimin tim ose që nuk e bëj para njerëzve. Publikja nuk është me rëndësi vetëm tek ata që jetojnë të tërhequr, në mal ose në ndonjë fushë, të cilët asnjëherë nuk dalin nga shtëpia dhe të cilët gati asnjëherë nuk takojnë askënd. Për të gjithë njerëzit e tjerë publikja është më e gjerë se personalja dhe e fshehura, sepse jetojnë, shkëmbejnë, bisedojnë, punojnë me njerëzit e tjerë. Gjithçka e tillë është publike. Prandaj çdokush duhet të mendojë se sjellja dhe fjalët e tij janë në publik dhe i nënshtrohen vlerësimit nga të tjerët (nga opinioni). Asgjë nuk mund të fshihet përgjithmonë, gjithçka shihet dhe kuptohet.

Çdokush, pra edhe fëmijët duhet të mendojnë si sillen në publik. Në këtë gjë prindërit i paralajmërojnë qysh në vegjëli duke iu thënë: „Pastrohu, do të të shohin të fëlliqur!, ose “Kujdes çka bën, të mos qortojnë ose të të qeshin!”, ose “Bëhu i mirë, të gjithë duhet të të duan”.



## SJELLJE E MIRË

Nëse je i keq dhe vepron diçka të pakëndshme, do të të refuzojnë, askush nuk do të shoqërohet me ty!, ose “Të lusim, vepro mirë, ti je nga familje me autoritet dhe ke kujdes në nderin tënd!” etj. (Përkujtohuni të dashur të rinj, në ndonjërin nga paralajmërimet e tilla nga prindërit tuaj dhe mendoni pse ua kanë thënë këtë). Në vendet tjera nxënësit kryesisht kanë pallto, bluzë ose uniformë shkollore. Atje mësuesit u thonë: “Ju lutemi jashtë të silleni mirë, siç ju ka hije nxënësve të shkollës sonë, që mos ta turpëroni emrin e shkollës!” (Edhe tek ne, nëse ndokush bën punë të këqija ndaj të tjerëve, fiton dënim me përjashtim.)

Do të thotë nuk duhet të jemi të mirë vetëm në shtëpi (ndoshta nga dashuria ndaj më të afërmeve ose nga frika nga ndëshkimi), kurse jashtë të sillemi thjeshtë, të egërsohemi dhe të lëndojmë edhe të vjetrit edhe të vegjlit (edhe këtu do të na mbërrijë dënimi kur të na takojë ndonjë më i fortë dhe më i hidhëruar, dhe do të na hakmerret për sjelljen e keqe). Nuk duhet të bëhemi si gjarpër duke i fshehur qëllimet, dhe kur dikush të kthejë shpinën dhe të shkojë, të veprojmë keq. Nuk guxojmë të bëhemi as edhe si dhelpër, të bëjmë lajka, duke menduar si të veprojmë keq. Patjetër duhet të jemi njerëz të vërtetë, njeri i cili para gjithkujt është i ndershëm, i njerëzishëm, i drejtë, që e do sjelljen e mirë të gjithkush, e mbi të gjitha ai mundohen vetë të ketë sjellje të mirë, gjithkund, e posaçërisht në publik.

### NOCIONET KRYESORE ETIKE

#### **NJERËZI -**

në përputhje me rregullat e sjelljes së mirë, përmbajtje në sjellje, maturi; **i njerëzishëm** - ai i cili sillet në mënyrë të pa imponueshme, korrektesisht dhe me elegancë, i cili “di çka duhet bërë”.

## NË PUBLIK, JASHTË SHTËPISË DHE PARA NJERËZVE TË TJERË

### ËSHTË MIRË NËSE FËMIJA:

- është i njerëzishëm,
- është i pastër dhe i rregulluar,
- është i veshur në mënyrë përkatëse për vendin dhe kohën,
- i përshëndet të gjithë,
- dashamirësisht është ndaj të gjithëve,
- ka buzëqeshje në fytyrë,
- nuk flet me të panjohur dhe refuzon të shkojë me ta larg shtëpisë dhe shkollës, (sepse mund të pësojë nga pedofilë dhe kriminelë) por menjëherë për atë e informon personin më të afërt dhe lutet të jetë i mbrojtur,
- nuk bën asgjë të keqe,
- nuk thyen degë dhe nuk prish lule,
- nuk i ndjek kafshët dhe nuk gjuan gurë pas tyre,
- u ndihmon më të vegjëlve dhe më të moshuarave, më të dobëtëve dhe më të varfërve,
- nuk bën zhurmë të madhe dhe ka kujdes në rendin dhe qetësinë,
- nuk zihet dhe nuk grindet me shokët,
- nuk i ndjek të rinjtë dhe nuk i detyron të bëjnë sende të këqija,
- nuk është jargavec t'u bëjë lajka më të mëdhenjve dhe më të fortëve, posaçërisht atyre që bëjnë keq,
- kur ta pyesin, përgjigjet lirshëm dhe flet drejtë, nuk e fsheh emrin e vet por krenohet me të dhe e tregon,
- flet njerëzishëm, nuk thotë fjalë të pakëndshme dhe nuk fyen,
- nuk pi duhan ndërsa shokët i këshillon edhe ata të mos bëjnë gjëra të këqija,
- nuk merr para nga askush, dhe menjëherë i kthen borxhet, si dhe sendet që ka huazuar,
- kurrsesi nuk merr drogë, largohet nga vendi ku flitet se ka, e nëse ndokush e detyron të marrë drogë, i tregon

### ËSHTË KEQ NËSE FËMIJA:

- nuk është i njerëzishëm dhe sillet pae dukatë,
- nuk është i pastër dhe i rregulluar,
- nuk është i veshur në mënyrë përkatëse për vendin dhe kohën,
- nuk përshëndet askënd,
- është pa dashamirësi ndaj dikujt ose ndaj të gjithëve,
- nuk ka buzëqeshje në fytyrë, gjithmonë është i vrenjtur dhe i prirë armiqësisht,
- bisedon me të panjohur dhe shkon me ta larg shtëpisë dhe shkollës (edhe pse mund të pësojë nga pedofilë dhe kriminelë) dhe për këtë nuk u tregon prindërve dhe mësuesit,
- bën të gjitha të këqijat,
- thyen degë dhe shkatërron lule,
- ndjek shtazët dhe hedh gurë drejt tyre,
- nuk iu ndihmon më të vegjëlve dhe më të vjetërve, më të dobëtëve dhe më të varfërve,
- gjithmonë zihet dhe grindet me shokët,
- bën zhurmë të madhe dhe nuk ka kujdes në rendin dhe qetësinë,
- si jargavec iu bën lajka më të rriturve dhe më të fuqishmëve, posaçërisht atyre që bëjnë keq,
- kur ta pyesin nuk përgjigjet dhe nuk flet drejtë, e fsheh emrin e vet, sikur të turpërohet nga ai,
- nuk flet njerëzishëm, thotë fjalë të pakëndshme dhe fyen,
- ndonjëherë pi duhan dhe alkool dhe krenohet para shokëve, dhe i këshillon edhe ata të bëjnë diçka të tillë,
- merr të holla nga çdokush, nuk i kthen borxhet as gjërat të cilat i ka huazuar,
- mendon si të marrë drogë, nuk ik nga vendi ku flitet se ka, dhe nëse dikush e detyron të marrë drogë, nuk u tregon prindërve apo mësuesit për atë detyrim të keq që shpie në sëmundje dhe të këqija,

## SJELLJE E MIRË

- prindërve ose mësuesit për këtë gjë, që shpie në sëmundje dhe të këqija
- të gjithë janë të kënaqur nga ai/ajo.
- askush nuk është i kënaqur nga ai/ajo.

## **BËHUNI KORREKT DHE TË NDRSHËM ME SHOKËT!**

Njeriu nuk jeton vetëm, ka familje, mëson dhe punon me shumë njerëz, rreth tij çdo kund ka njerëz, kudo që të shkojë takon të njohur dhe të panjohur. Një pjesë prej tyre i mbeten të afërt, afrohen për shkak të dëshirave, përpjekjeve të ngjashme, me ta e ndan punën dhe argëtohet, me ta bisedon shpesh dhe lehtë, bën punë të njëjta, mundohen ndërmjet veti të tregojnë mendime dhe përkrahen në realizimin e qëllimeve. Ata janë shokë, shoqërohen, janë të bashkuar në kohën e përbashkët, në rritjen dhe jetën.

Shok do të thotë i barabartë me tjetrin. Shokët duhen dhe respektojnë barabarësinë. Nuk ka shoqëri nëse ndonjëri është i një rangu tjetër dhe detyron tjetrin ta dëgjojë. Prandaj edhe nëse ka shokë të moshës së ndryshme dhe të profesioneve të ndryshme ose shkojnë në shkolla të ndryshme, zakonisht shokët janë të një gjenerate, jetojnë afër, mësojnë bashkë dhe janë të ngjashëm me qëllimet. Nëse janë të ndryshëm ata plotësohen - nëse ndonjëri është më i vjetër, e orienton më të voglin, nëse ndokush është më i fortë e mbron më të voglin; nëse ndokush din apo kupton diçka të re, e ndan me shokët tjerë. Shoqëria është një gjë e bukur dhe njerëzit synojnë të kenë shokë dhe janë të lumtur nëse shoqëria është e sigurtë dhe e këndshme.

Meqenëse shoqëria është e shpeshtë dhe ka mjaft karakteristika të mira, ndërsa nënkupton lidhshmëri të afërt të njerëzve në jetë, në punë dhe zbavitje, ajo paraqet shumë kërkesa etike para anëtarëve të vet. Së pari mos kamufiloni për shoqëri, të mundoheni të bëheni shokë me dikë që nuk ju pëlqen. Shoqëria e tillë nuk do të zgjat sepse lidhja shoqërore është një lloj dashurie, dashuri e vërtetë. Nëse nuk je shok me ndokënd, me të mund të jeni në raporte korrekte, të përshëndeteni, të bisedoni për punë apo dhe për ndonjë gjë tjetër, të shkëmbeni libra dhe tjera gjëra, por nuk është patjetër të jeni të afërt në shpirt. Me ata që jeni të afërt, raportet janë ndryshe, më të hareshme, bisedojnë për aspiratat dhe synimet personale dhe ndihmohen në realizimin e tyre.



Atëherë shpesh mendoni në shokun, planifikoni me të ta kaloni kohën ose të bëni diçka të përbashkët, nëse keni diçka të bukur (çokollatë ose biletë për ndeshje sportive) dëshironi t'i ndani bukuritë dhe shpresoni dhe pritni që edhe ai të mendojë dhe veprojë ashtu me ju.

Për shokët më me rëndësi është të kenë raporte të pastra. Nuk ka sukses shoqëria në të cilën njerëzit nuk sillen korrekt, fer, përshtatshëm dhe pa respekt. Shoku nuk tallet me shokun, që ta ofendojë dhe lëndojë. Shoku i vërtetë insiston gjithçka të ndajnë, edhe vuajtjen edhe kënaqësitë. Shoku i mirë e mbron dhe nuk e lëndon shokun e vet. Dhe çdoherë më së shumti e respekton shokun, saqë ndonjëherë të tjerët hidhërohen pse shoku e dallon shokun e tij, ndërsa të tjerët jo aq. Por, e tillë është dashuria.

Shoqëria është raport shumë i shpeshtë. Edhe njerëzit e këqij kujdesen të mos i bëjnë keq shokut të vet (edhe pse ajo vështirë mbahet, sepse të këqijtë nuk mund të ndalen së qeni të këqij). Qysh në Antikë është folur se në shoqëri njeriu mundohet të bëhet më i mirë, që të jetë i dashur nga shoku i tij. Prandaj kanë dalluar shoqërinë si përpjekje e njerëzve



të bëhen më të mirë bashkë me shokun e tij. Shoku asnjëherë nuk e gënjen shokun e tij, dhe ky nuk hidhërohet nëse ky ia tregon të vërtetën. Në të holla ata kryesisht ndajnë gjithçka, por shokët ndërmjet veti asnjëherë nuk mashtrojnë, sepse ajo do të thotë tradhti dhe shfrytëzim, ndërsa shoku nuk dëshiron t'ia bëjë atë të afërmit të tij.

Është mjaft e rëndësishme që djemtë të kenë shoqe dhe vajzat të kenë shokë. Ashtu jo vetëm që njoftohen gjinitë, por ndërmjet veti bashkohen për të qenë së bashku tërë jetën, kur njëri-tjetrit do t'i nevojiten. Kjo e mundëson shoqërinë qysh në vegjëli.

## DJEMTË DHE VAJZAT DUHET TË JENË MIQ

Njeriu ekziston në dy lloje, si person mashkull dhe femër. Në natyrë çdo lloj ka dy gjini dhe çdo shtazë në botë e ka të përcaktuar gjininë. Duali është fat i çdo qenie. Prandaj asnjë nga qeniet e gjalla në botë nuk jeton vetëm, çdonjëra është pjesë e një çifti.

Kështu, çdo vajzë dhe çdo djalë janë vetëm njëra nga dy anët e afërsisë të dy qenieve njerëzore nga gjini të ndryshme. Çdo njeri ka nënë dhe baba, të cilët e kanë lindur. Edhe prindërit janë të lindur nga nëna dhe babai. Askund nuk ka ekzistim pa atë lidhje të dy qenieve të gjinisë femërore dhe mashkullore. Kështu është e caktuar në natyrë.

Por nuk ka jetë pa unitet, bashkëpunim dhe shoqëri mes djemve dhe vajzave. Edhe fëmijët janë të bashkuar si djem dhe vajza, shokë dhe shoqe në një klasë dhe në shoqërinë e vet. Si do të ishte e njëtrajtshme, e zbrazët dhe e pikëlluar sikur në mbarë botën të kishte vetëm vajza ose vetëm djem?!

Ardhmëria e çdokujt është të jetë me shokë dhe të afërmit edhe të gjinisë së vet edhe të gjinisë së kundërt. Femrat duhen të jenë të afërta me djemtë, ndërsa djemtë me vajzat. Gjithë jetën na ndjek ai bashkim natyror i meshkujve dhe femrave.

Kuptohet edhe vajzat edhe djemtë duhet të jenë të vetëdijshëm dhe krenar për natyrën e vet, por edhe të kuptojnë qenësinë e të tjerëve. Tash duhet të mendojmë për të ardhmen dhe për detyrat që do t'i kryejmë së bashku. Duhet të jemi të mirë dhe të sillemi pozitivisht. Duhet t'i gëzohemi jetës dhe të veprojmë mirë që ta ruajmë jetën në çdo formë, si bimë, qenie shtazore, qenie njerëzore, si ujë, trualli dhe klima.

Qeniet femërore duhet veçmas të kuptohen - ato duhet të dhurojnë jetë të re. Por ato këtë nuk mund ta bëjnë pa meshkujt. Prandaj të dy palët duhet të mbajnë llogari dhe kujdes për jetën dhe ekzistimin e tyre, të rriten, të zhvillohen mirë, ta ruajnë shëndetin, të bëhen profesionistë të cilët do të bëjnë gjëra të mira dhe do të përparojnë në jetë, të shoqërohen me moshatarët e tyre, familjarët, fqinjët dhe kolegët, të duan të afërmit, sepse të gjithë jemi njerëz.

Edhe djemtë edhe vajzat kanë obligime të mëdha edhe në shkollë edhe në shtëpi. Dhe do të kenë edhe më shumë kur të rriten. Këtë e imponon bota dhe jeta, por ata do të mundohen të trajtohen që të dinë t'i kryejnë. Nuk do të frikohen nga vështirësitë e jetës, sepse çdo vështirësi mund të kalohet - sot në shkollë, si dhe ato në ardhmërinë të afërt dhe të largët. Ata janë të guximshëm dhe mësojnë si t'ia dalin mbanë me brengat.

Për këtë nuk duhet trimëri e veçantë. Është e nevojshme vetëm seriozitet, vendosmëri dhe durim, nëse paraqitet detyrë apo problem. Dhe nëse duhet, të bashkëpunohet, si dhe të kërkohet dhe të jepet ndihmë. Dhe detyrimisht, në fytyrë duhet të ketë buzëqeshje, sepse ajo e ruan shpirtin dhe moralin dhe atëherë mund të përballohet gjithçka.

Por një nga rregullat më të rëndësishme është që djemtë dhe vajzat të jenë miq dhe të respektohen ndërmjet veti. Vetëm kështu mund t'i kuptojnë ata që janë të ndryshëm prej tyre, e që janë më të afërmit. Vetëm me miqësi midis vajzave dhe djemve mbahet shoqëria, njerëzia dhe dashuria, si ndjenja më të bukura dhe si etikë më e mirë.

## NJERIU ËSHTË NJERI SIPAS SHPIRTIT, E JO SIPAS PANTALLONAVE

*Pedagog kroat Antun Radiq*



### VAJZAT DUHET

- + T'i duan dhe t'i respektojnë shokët e tyre!
- + Të mos frikohen të garojnë me djemtë!
- + T'u ndihmojnë shokëve të tyre dhe gjithë djemve!



### MESHKUJT DUHET

- + T'i duan dhe respektojnë shoqet e tyre!
- + Të mos frikohen të garojnë me vajzat!
- + Të ndihmojnë shoqet e tyre dhe gjithë qeniet femërore!



### VAJZAT NUK DUHET

- Të largohen nga shokët!
- Të flasin keq për djemtë!
- Të mos i ndihmojnë djemtë, të frikohen nga ata!



### MESHKUJT NUK DUHET

- Të mos ndihmojnë femrat, të largohen nga ato!
- Të largohen nga shoqet!
- Të flasin keq për vajzat!

## NË RELACIONET ME SHOKË

### ËSHTË MIRË NËSE FËMIJA:

- shoqërohet me ata që i do,
- është i sjellshëm me shokët,
- njeh familjet e shokëve dhe shokë të tjerë (nga lagja tjetër) dhe përshëndetet me ta,
- nëse sheh që ndokush është vetë dhe nuk ka shokë, i afrohet dhe bisedon dhe i ofron ndihmë,
- nuk i largohet shokut, por rregullisht takohet me të,
- nuk e zgjedh shokun sipas pasurisë, por sipas moralit dhe vetive të mira,
- i ndan me shokun të gjitha idetë,
- me shokun ndërtojnë dëshira të mira dhe pozitive,
- ia tregon shokut të tij brengat dhe dëgjon brengat e tij dhe i ndihmon,
- asnjëherë nuk e mashtron shokun,
- çdoherë është në anën e shokut të tij,

### ËSHTË KEQ NËSE FËMIJA

- shoqërohet me ata që nuk i do, ndërsa i fshehë të gjitha interesat tjera personale për lidhshmëri të tillë,
- nuk është i sjellshëm me shokët,
- nuk i njeh familjet e shokëve dhe shokë të tjerë (nga lagje tjetër) dhe nuk përshëndetet me ta,
- nëse sheh që ndokush është vetë dhe nuk ka shokë, nuk i afrohet, nuk bisedon dhe nuk i ofron ndihmë,
- i largohet shokut, ikën që të mos takohet me të,
- e zgjedh shokun për nga pasuria e jo për nga morali dhe vetitë e mira,
- nuk i ndan me shokun idetë e veta,
- nuk ndërton me shokun dëshira të mira dhe pozitive,
- nuk i tregon shokut brengat e tij dhe nuk i dëgjon brengat e tij dhe nuk i ndihmon,

## SJELLJE E MIRË

- nëse shoku vepron diçka të keqe, i tregon që të përmirësohet,
  - çdoherë është i ndershëm në raportet me shokun,
  - asnjëherë nuk e vjedh shokun,
  - nuk grindet dhe nuk rrihet me shokët (çfarë shokë do të ishin ata?!),
  - nuk pi duhan dhe alkool, por i këshillon edhe ata të mos bëjnë gjëra të këqija,
  - nëse ndokush nga shokët merr drogë, e qorton dhe e ndërpret shoqërinë, sepse droga është sëmundje ngjitëse dhe secili që sillet rreth saj mund të pësojë,
  - shokët janë të kënaqur nga ai/ajo.
- e mashtron shokun,
  - nuk qëndron çdoherë në anën e shokut,
  - nëse shoku vepron diçka të keqe, nuk i tregon që të përmirësohet,
  - nuk është i ndershëm në raportet me shokun,
  - ndonjëherë e vjedh shokun,
  - grindet dhe rrihet me shokët (çfarë shokë janë ata?!)
  - pi duhan dhe alkool me shokët, ndërsa të tjerët i këshillon të bëjnë gjëra të këqija,
  - nëse ndokush nga shokët merr drogë, nuk e qorton dhe nuk e ndërpret shoqërinë, edhe pse droga është sëmundje ngjitëse dhe çdokush që sillet rreth saj mund të pësojë,
  - shokët nuk janë të kënaqur nga ai/ajo.

## KUJDESUNI PËR VETEN DHE PËR TË TJERËT DHE NDIHMONI!

Si e dini që veproni mirë?! Mund të mendoni dhe t'ju duket se sjellja juaj është e mirë, ndërsa në fakt ju nuk veproni mirë. Matësi për sjellje është së pari në ju, por edhe njerëzit tjerë ju vlerësojnë çfarë jeni dhe si silleni.

Ekzistojnë mundësi të ndryshme për të kontrolluar sjelljen tuaj. Së pari, duhet të njihni dhe të ndiqni normat e mëdha morale, si Dhjetë Urdhrat e Zotit, në të cilat thuhet çka është më me rëndësi të bëhet dhe ndalohet ajo që kurrë nuk guxon të bëhet (të mbytet njeri, të gënjëhet dhe vjedhjet, të mashtrohet më i afërmi, lakmohet dhe të dëshirohet dhe merret ajo që i takon tjetër kujt). Ekzistojnë një grup i këshillave të tilla, të cilat nëse njeriu i dëgjon, vepron mirë. I tillë është imperativi i etikës nga Shën Klimenti i Ohrit: *Largohu nga e keqja dhe vepro mirë!* Ai na mëson t'i largohemi të keqes dhe të mos mendojmë asgjë të keqe të tjerëve, dhe gjithashtu çdoherë të bëjmë mirë. Është mirë kur më shumë herë ju tërheqin vëmendjen se diçka nuk bëni mirë, të mendoni dhe të përmirësoheni.

Ka një matës modern i cili mund t'ju shërbejë kur nuk jeni të sigurt si të veproni; ai thotë: *Asnjëherë askënd mos lëndo, çdoherë ndihmo!* Atë që keni ndërmend të bëni ose e keni bërë, kontrolloni sipas këtij matësi etik, dhe do të shihni a jeni orientuar si duhet. Nëse nuk lëndoni askënd (dhe as veten), është mirë, atë mund ta bëni. Gjithashtu nëse i ndihmoni ndokujt, atë duhet ta bëni. Megjithatë, nëse me sjelljen tuaj lëndoni ndokënd, ose veten, atë assesi nuk duhet ta bëni, dhe nëse keni bërë ashtu diçka, duhet të kërkoni falje dhe të thoni që një gjë të këtillë nuk do të bëni më. Gjithashtu, nëse nuk ndihmoni, ndërsa ndokush ka nevojë për ndihmën tuaj, atëherë nuk keni menduar mirë, por duhet të ndryshoni dhe më mirë të silleni, duke i ndihmuar atij që ka nevojë.

Kontrollojeni këtë duke i paramenduar të gjithë njerëzit që i njihni, ose edhe disa të cilët rastësisht do t'i kishit takuar. Si do të veproni? Si egërsirë, duke futur të këqija ose duke ushtruar dhunë - ose si fëmijë i edukuar mirë, duke mos lënduar askënd dhe duke ndihmuar? Sa është kjo e rëndësishme mund të shihni kur të krahasoni sjelljen tuaj ndaj të sëmurëve ose ndaj atyre që kanë ndonjë handicap: janë të verbër apo shikojnë dobët, janë të shurdhur, shurdhmemec, pa dorë



ose pa këmbë ose me gjymtyrë të lënduara. A do të talleni me personat me handicap, ose do t'i doni si të gjithë njerëzit? A do t'ju vini stërkëmbës ose do t'ju ndihmoni të orientohen në hapësirë? Nëse duhet, a do t'ju ndihmoni të bëjnë diçka, të pinë ujë, ose t'i dërgoni në shtëpi, ose diçka të ngjashme të mirë për ata - apo do të ikni dhe nga anash do t'i përqeshni që janë të sëmurë dhe nuk mund të shohin, që nuk janë të shpejtë ose të bëjnë diçka sikur ju?

Më parë njerëzit janë tallur me të hendikepuarit (ata të cilët kanë ndonjë mangësi - por të tillë janë, mbani mend 10% e të gjithë njerëzit). Sot mbizotëron humanizmi, i cili përmban sjellje pozitive ndaj invalidëve - si dhe ndaj gjithë njerëzve. Duhet të kemi dashuri dhe respekt për gjithë krijesat e gjalla. Prandaj edhe e ruajmë natyrën, nuk i thyejmë degët e drurëve, nuk i lodhim kafshët, e zhvillojmë edhe ndihmën për invalidët, për pleqtë, për fëmijët e sëmurë, për të varfrit, për ata të cilët kanë pësuar nga tërmetet, nga përmytjet, nga infeksionet. Parimi bazë i etikës së re është të mos lëndohet askush dhe t'i bëhet mirë gjithkujt, t'i ndihmohet çdonjëri. Prandaj fëmijët duhet të parët të mësohen të jenë të

## SJELLJE E MIRË

kujdesshëm, të kujdesen për të gjithë, edhe për veten - dhe gjithmonë të sillen mirë, sepse ajo është zgjedhja e vërtetë e moralit të çdo njeriu të mirë

### NË RELACION ME NJERËZIT E TJERË

#### ËSHTË MIRË NËSE FËMIJA:

- e di që nuk guxon të lëndojë askënd dhe kujdeset të sillat ashtu,
- dëshiron t'i ndihmojë çdokujt dhe mundohet të ndihmojë,
- kujdeset për të gjitha qeniet e gjalla dhe nuk i lëndon ato,
- e do dhe e ruan natyrën,
- kujdeset për bimët dhe nuk i thyen degët e drurëve,
- kujdeset për kafshët dhe nuk ushtron dhunë ndaj tyre,
- respekton të gjithë njerëzit dhe me asgjë nuk i lëndon,
- kupton që invalidët vuajnë dhe nuk dëshiron me asgjë plotësuese t'i lëndojë,
- dëshiron t'u ndihmojë invalidëve dhe u ndihmon kur mundet,
- nëse ndonjë shok bën diçka të keqe ndaj invalidëve ose nuk dëshiron t'u ndihmojë, i tregon se ajo nuk është e mirë dhe se të gjithë jemi njerëz, që duhet të ndihmohemi (sepse, nëse invalidët nuk mund të na ndihmojnë neve, ndonjë më i vjetër dhe më i aftë ndonjëherë do të na ndihmojë)
- sillat si njeri i vërtetë - me ndjenja të bukura, me mendime pozitive dhe sjellje të mirë,
- të gjithë mendojnë se fëmija është i edukuar mirë, nuk lëndon askënd, gjithkujt i ndihmon dhe sillat në rregull.

#### ËSHTË KEQ NËSE FËMIJA:

- nuk dëshiron të dijë se nuk guxon të lëndojë askënd, nuk kujdeset për të tjerët dhe i lëndon,
- nuk dëshiron t'i ndihmojë askujt,
- nuk kujdeset për krijesat e gjalla dhe i lëndon,
- nuk e do dhe nuk e ruan natyrën,
- nuk kujdeset për bimët dhe i thyen degët e drurëve,
- ushtron dhunë ndaj kafshëve,
- nuk i respekton njerëzit dhe me diçka i ofendon dhe lëndon,
- nuk kupton se invalidët vuajnë (mohon se ajo është me rëndësi) madje edhe dëshiron t'i lëndojë edhe më shumë,
- nuk dëshiron t'u ndihmojë invalidëve,
- nëse ndonjë shok bën diçka të keqe ndaj invalidëve ose nuk dëshiron t'u ndihmojë, e lavdëron dhe thotë se kjo gjë është „bukur” dhe se është marrëzi të themi që të gjithë jemi njerëz, që duhet të ndihmohemi (duke thënë që invalidët nuk mund të na ndihmojnë neve, dhe nuk duhet të presim ndonjëri, ndonjëherë të na ndihmojë),
- nuk sillat si njeri i vërtetë, nuk ka ndjenja të bukura, përhap mendime negative me dëshirë të lëndojë ndokënd dhe ta mashtrojë dhe nuk sillat mirë,
- të gjithë mendojnë se fëmija nuk është mirë i edukuar, shpesh lëndon ndonjërin, nuk ndihmon askënd dhe nuk sillat në rregull.

## BONTONI I TË RINJVE

Të gjithë njerëzit duhet të sillen mirë. Ajo kërkohet edhe nga të rinjtë, edhe nga të pleqtë. Madje edhe fëmijët më të vegjël paralajmërohen çka të bëjnë, të lajnë duart para ushqimit, të mos teprojnë në kërcim, të kujdesen të mos thyejnë diçka, të përmbahen kur janë mysafirë, të thonë „Urdhëro” dhe „Faleminderit”. Qëllimi është që të gjithë për fëmijën të thonë „është mirë i edukuar”.

Kur të shkojnë në shkollë, nga fëmijët kërkohet dhe pritet të jenë të qetë në orë, të dëgjojnë mësuesit, me kohë t'i bëjnë detyrat e shtëpisë, të jenë nxënës të denjë të shkollës. Atëherë nxënësit fillojnë të shoqërohen me më shumë moshatarë, të shkojnë në shtëpi të tyre, të luajnë me shokët jashtë, së bashku me shokët të vizitojnë kinematë, klube sportive apo të internetit. Ajo do të thotë që edhe vetë duhet të kujdesen çka bëjnë dhe të veprojnë mirë, pa mbikëqyrje të prindërve.

Dikush mendon se në shtëpi nuk guxon të bëjë çka të dojë “sepse aty e shohin prindërit ose gjyshja – ndërsa jashtë është vetëm dhe mund të bëjë çka të dëshirojë. Ajo nuk është e saktë. Njerëzit kanë përcaktuar si duhet të jetë sjellja në çdo situatë. Duhet të mësohet si është sjellja e mirë në vende të ndryshme dhe para njerëzve të ndryshëm. Ajo quhet **etiketë** ose **bonton**, që do të thotë sjellje e drejtë. Disa sjellje priten nga çdokush në kohë të caktuar, në çdo vend dhe në situata të ndryshme. Kush nuk sillet ashtu, llogaritet si i paedukuar, i pamësuar, i pa ndërtuar, e vlerësojnë se nuk di si është sjellja e drejtë dhe prandaj tallen me të dhe largohen prej tij/saj.

Ka rregulla të ndryshme për bonton, të cilat duhet t'i dinë dhe t'i zbatojnë edhe fëmijët.

### NOCIONET KRYESORE ETIKE

#### **BONTON -**

rregulla të sakta (formale) për sjellje, drejtim, veshje, për mënyrën e folurit në raste të ndryshme, në vende të caktuara dhe ndaj njerëzve të ndryshëm (*ngjashëm etiketim*).

## ÇKA DHE SI ËSHTË MIRË SIPAS BONTONIT PËR FËMIJËT

Bontoni për fëmijë, edhe për djemtë edhe për vajzat është një varg i sjelljeve që kërkohet nga fëmijët t'i bëjnë. Nëse veprojnë si kërkohet, atëherë do t'i llogarisin për të edukuar, nëse veprojnë të kundërtën, i llogarisin të paedukuar, se „nuk e njohin bontonin”.

Fëmija **duhet të lahet dhe rregullohet** në mëngjes dhe çdoherë para se të dalë - përndryshe do ta llogarisin për të parregulluar dhe do t'i largohen.

Fëmija **nuk duhet të dale i zhytur**, me rroba dhe çorapë të grisura, sepse gjithçka mund të pastrohet dhe të qepet - përndryshe, do të tallen me të.

Fëmija **duhet të flasë mirë**, pa zë të lartë, të mos grin-det, të mos urdhërojë (sikur të ishte komandant!) – nëse vepron në të kundërtën askush nuk do të dëshirojë të shoqërohet me të.

Fëmija **duhet të ushqehet qetë**, me kafshata më të vogla, me thikë dhe pirun, pa ngrënie dhe përtypje të shtrembra – ose do ta quajnë të pasjellshëm, nuk do ta marrin në shoqëri dhe nuk do ta thërrasin në ahengje me ushqim.

Fëmija **duhet të përdorë fjalët e ndershme**. Urdhëro, kur dëshiron diçka të pyesë apo të kërkojë; Urdhëro - Urdhëroni, kur diçka jep; Faleminderit, kur do t'i japin diçka ose do t'i kryejnë shërbim; Më fal - Më falni, kur kërkon falje për diçka çka ka bërë ose nuk është mirë ose kur kërkon për ta dëgjuar – nëse nuk vepron ashtu e llogarisin të paedukuar.

Fëmija **nuk duhet të flasë fjalë të pista dhe sharje** – nëse vepron më ndryshe do të frikohen nga ai, do ta llogarisin të thjeshtë dhe nuk do të ketë shokë të mirë (do të ketë vetëm të atillë sikur ai - që së bashku të flasin gjëra të këqija).

Fëmija **duhet të ketë kujdes të sillet mirë**, të mos jetë i dhunshëm, të mos i shtyjë shokët, të mos lazdrohet dhe të mos jetë lavdraç - përndryshe nuk do ta duan dhe do të thonë se është i paedukuar.

Fëmija **duhet të mbajë shami** për hundë dhe për fshirjen e gojës (pëlhere ose letre) - nëse fshihet me mëngë ose i nxjerr dhe i gjuan sekretet e hundës me gishta, të gjithë do ta përqeshin dhe do të tregojnë me gisht kah ai.



**Fëmija nuk duhet të futë gishtin në hundë, laps në vesh, nuk duhet të kruhet nën këmbë – përndryshe të gjithë do të tallen me të.**

**Fëmija nuk shkarravit nëpër libra dhe fletore,** ato duhet të jenë në rregull, sepse janë pasqyrë e nxënësit, dhe gjithashtu nuk duhet t'i shkatërrojë librat dhe fletoret e tjerëve – nëse bën ashtu nuk do ta duan dhe disi do ta dënojnë sjelljen e atillë të keqe.

**Fëmija në autobus u lëshon vend më të moshuarve** dhe nuk sajon tregime se është i sëmurë dhe të gjithë duhet të ndiejnë keqardhje për të dhe t'i lëshojnë vend - sepse do të habiten dhe do të qeshin, do ta vlerësojnë si fëmijë të keq dhe do ta përcjellin me fjalë të këqija.

**Fëmija në kinema nuk bërtet** kur të fiken dritat, sepse gjoja tash është koha për të treguar pandershmëri (kohë të atilla asnjëherë nuk ka) - nëse nuk sillet si duhet, do ta nxjerrin jashtë.

**Fëmija nuk duhet të lëshojë flokët t'ia mbulojnë fytyrën dhe sytë** (mund ta prishë shikimin), por edhe djemtë edhe vajzat të cilët kanë flokë pak më të gjata duhet rregullisht t'i lajnë dhe t'i kapin me llastik - kush nuk është i pastër dhe i rregulluar të gjithë do t'i largohen ose do ta përqeshin.

**Fëmija kur është mysafir tek të tjerët nuk është më i keq se në shtëpi,** edhe në shtëpi gjithashtu nuk është i keq, as nuk i prish sendet dhe disponimin e të tjerëve me kërcimet e veta dhe sjelljen e keqe – përndryshe nuk do ta ftojë ose çojnë mysafir ose ta lëshojnë tek të tjerët në shtëpi.

**Fëmija në ndeshjet sportive nuk bën faull** dhe nuk dëshiron të gënjejë për atë që e ka bërë, por sillet fer – nëse është i ashpër dhe mashtron, do ta largojnë, dhe tjetër herë sigurisht nuk do ta thërrasin të luajë.

**Fëmija i kthen me kohë librat, filmat dhe lojërat e huazuara,** ndonjëherë edhe para afatit të caktuar - sepse nëse nuk i kthen, do ta llogarisin vjedhës dhe nuk do ta thërrasin mysafirë si dhe nuk do t'i huazojnë asgjë.

**Fëmija nuk shikon në dosarët e huaj dhe nuk tallet me askënd në Internet** – nëse vepron të kundërtën, nuk do ta thërrasin që së bashku të shikojnë diçka, as nuk do t'i tregojnë çka kanë gjetur, dhe hakmarrja për të bërë gjëra të pakëndshme në Internet mund të jetë shumë e keqe, ai fëmijë do të bëhet mjet për tallje.

## SJELLJE E MIRË

Ka edhe shumë rregulla të tjera të bontonit – të gjitha duhet të mësohen dhe fëmija duhet t'u përmbahet. Rregulla e përgjithshme është:

### **BËJE VETEM ATË QË MENDON SE EDHE TE TJERET DUHET TA BËJNË (TY)!**

Kështu bontoni ndërlidhet me etikën e përgjithshme.

### **MË I MIRI ËSHTË MATËSI!**



Matematikani i njohur Pitagora ka shkruar veprën më të njohur të etikës për të rinjtë – **VARGJET E ARTA TË ETIKËS**, poemë të cilën e mësojnë gjeneratat e reja nga Antika e deri më sot:

**Mendo para se të fillosh**, të mos bësh ndonjë marri -  
njeriu e ka karakteristikë të punojë dhe të flasë çmenduria.  
**Bëje atë që më vonë nuk do të mundojë!**

Nuk duhet ta lësh anash shëndetin fizik -  
Por në ushqim, pirje dhe ushtrim bëhu i matur.  
**Masa është ajo e cila nuk do të të shkaktojë brengë.**  
Mësohu të jetosh jetë të pastër, të butë dhe dinjitoze!  
Kujdes mos e bëj atë që në njeriun e ngjall pangopësinë!  
Mos shpenzo pa nevojë,  
as edhe dorështrënguar të jesh - **në gjithçka më e mira është masa...**

Mos lejo që ëndrra në mbrëmje t'i mbyllë sytë -  
Para se të bësh kontroll ditës që kaloi:  
Ku gabova? Çka bëra? Çka nuk munda të bëj?  
Nëse ke bërë keq, pendohu; nëse ke bërë mirë, gëzohu!  
Në atë ushtrohu, atë bëje dhe kah ajo drejtohu:  
Rruga e atillë do të të nxjerrë në rrugën e mirësisë hyjnore.

## PYETJE PËR PËRSËRITJE

A duhet që për pyetjet e etikës vetëm të diskutohet apo të pritët, kur njeriu të zbulojë vlerat dhe normat e vërteta, ai/ajo ato t'i kryejë?

Si vlerësohet sjellja në të cilën me dëshirë të madhe dhe vazhdimisht bëhet mirë?

Sjellja e mirë a ka zbatim në fusha të ndryshme të jetës dhe në relacione të ndryshme mes njerëzve?

Çka është familja për njeriun? Çka bëhet në familje? Si duhet të jenë relacionet mes anëtarëve të familjes?



Përshkruani shkurt një ditë në familje dhe çka duhet të veprojnë anëtarët e saj që të gjithë të ndjehen mirë.

A ka rregulla të sjelljes në shkollën tuaj? Përshkruani kodeksin e sjelljes në klasën tuaj dhe shkollën tuaj?

Cilat janë detyrat elementare morale të nxënësit në sjelljen në shkollë?

Çka do të thotë sjellje e mirë ndërmjet shokëve?

Si duhet të sillen në mes veti pjesëmarrësit femër dhe mashkull?

A duhet shokët t'i shkelin normat morale ose duhet që së bashku të mundohen të jenë më të mira?



Përshkruani çka do të thotë pirja e duhanit dhe alkoolit për fëmijët - nxënës në shkollat fillore.

Përshkruani a duhet fëmijët - nxënës në shkollë fillore të marrin drogë.

Kujt duhet t'i tregojnë nëse ndokush i detyron të drogohen?

Si janë normat elementare të sjelljes para opinionit?

A duhet jashtë të jeni më pak të kulturuar sesa në shtëpi?

A guxoni në shtëpi të bëni çfarëdo gjërash, sepse jeni të mbrojtur nga muret (njerëz tjerë nuk ju shohin)?

Si duhet të silleni ndaj invalidëve? A meritojnë ata shumë sjellje të kujdesshme morale ndaj tyre?

Çka do të thotë bonton?

Veprimi sipas bontonit a tregon se nuk mbani kujdes për sjelljen ose se jeni të edukuar?

Nëse dikush nuk vepron sipas bontonit, si do të reagoni - e qortoni apo i largoheni prezencës së tij?



Përshkruani cilën nga normat e parashtruara ju posaçërisht e vlerësoni dhe gjithsesi e zbatoni?

Cila është ideja themelore e etikës së Pitagorës në Vargjet e Arta?

A është e dobishme të lexoni dhe t'i dini Vargjet e Arta të Pitagorës?

## PËRMBAJTJA

I. ETIKA DHE MORALI	3
1. Çka është etika	4
2. Morali	7
3. Rëndësia e moralit	10
4. Shën Klimenti i Ohrit - mësuesi ynë i moralit	15
5. Tekste të etikës dhe Pyetje për përsëritje	17
II. VLERA UNIVERSALE ETIKE	19
6. Etika në botë	20
7. Ndershmëria është mirësia më e madhe	23
8. Çdoherë thuaje të vërtetën!	25
9. Drejtësia është forca e barazisë	28
10. Patriotizmi mbron vendin dhe popullin	30
11. Etika e sotme	33
12. Etika universale	37
13. Tekste të etikës dhe Pyetje për përsëritje	39
III. SJELLJE E MIRË	41
14. Sjellje e mirë	42
15. Në familje duhet të gjithë të duhen, të respektohen dhe të ndihmohen	46
16. Mëso vyeshëm, ndërsa në shkollë bëhu shok me të gjithë	49
17. Secili duhet të ketë kujdes si sillet publik	53
18. Bëhuni korrekt dhe të ndershëm me shokët!	56
19. Kujdesuni për veten dhe për të tjerët dhe ndihmoni	60
20. Bontoni i të rinjve	63
21. Tekste të etikës dhe Pyetje për përsëritje	66